

RAPORT MONITORIMI

“NJOHJA E TË DREJTËS PËR NDIHMË JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

 **LIBRAZHD**

 **HIMARË**

 **KUKËS**



Periudha e Monitorimit
Shtator 2020-Shtator 2021

TIRANË, JANAR 2022



RAPORT MONITORIMI

“NJOHJA E TË DREJTËS PËR NDIHMË JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI”

*Të dhëna të grumbulluara gjatë misioneve të monitorimit
të realizuara në qytetet Kukës, Himarë dhe Librazhd*

Tiranë, Janar 2022

Ky raport u përgatit si pjesë e projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" i cili zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC)."



Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin e UNDP, Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim apo partnerit kombëtar.

Punoi:

Z. Njazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Z. Erdion Maçolli – Avokat, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rishikoi:

Znj. Ardita Kolmarku – Juriste/Menaxhere Projektsh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr.Brigada e VIII-të, Pallati "TeknoProjekt"
Shk. 2, Ap. 10, Tirana – Albania
Kutia Postare nr. 1752
Tel: 04 2233671
Cel: 0694075732
E-mail: office@ahc.org.al

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
KREU I	9
1. OBJEKTI, QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT	9
1.1. Objekti i raportit.....	9
1.2. Qëllimi i raportit	9
1.3. Metodologjia e raportit.....	9
1.3.1. Faza e mbledhjes së të dhënave.....	10
1.3.2. Faza e përpunimit të të dhënave dhe hartimi i raportit.....	10
2. VËSHTRIM I SHKURTËR I LIGJIT NR. 111/2017 “PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI”	10
MONITORIMI I ECURISË SË MIRATIMIT TË AKTEVE NËNLIGJORE DHE PËRGJEGJËSISË SË INSTITUCIONEVE PËRKATËSE	12
KREU II.....	15
1. QASJA INSTITUCIONALE NË RAPORT ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS.....	15
1.1. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	15
1.2. Qasja e institucioneve në nivel vendor në qytetin e Librazhdit	16
1.2.1. Bashkia librazhd	16
1.2.2. GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN DHE PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN	17
1.3. Qasja e institucioneve në nivel vendor në qytetin e Himarës.....	19
1.3.1. Bashkia himarë.....	19
1.3.2. GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË DHE PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR VLORË.....	20
1.4. Qasja e institucioneve në nivel vendor në qytetin e Kukësit	21
1.4.1. Bashkia Kukës.....	21
1.4.2. GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS DHE PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KUKËS	22
KREU III	23
1. Anketime me qytetarë: “Në kërkim të ndihmës juridike të munguar në qytetin ku banoj”.....	23

1.2. Qytetarët banues të bashkisë Librazhd	23
1.3. Qytetarët banues të bashkisë Himarë	26
1.4. Qytetarët banues të bashkisë Kukës.....	29
GJETJET KYÇE DHE REKOMANDIME	33
ANEKS 1.....	36
ANEKS 2.....	40

LISTA E SHKURTIMEVE

Ligji nr.111/2017 "Për Ndhimën Juridike të garantuar nga Shteti"- Ligji nr.111/2017
Ligji nr.10039, datë 22.02.2008 "Për ndihmën juridike", i shfuqizuar - Ligji nr.10039/2008
Ministria e Drejtësisë - MD
Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas – DNJF
Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike - KSHNJ
Këshilli i Ministrave - KM
Organizatat jo-fitimprurëse - OJF
Vendim i Këshillit të Ministrave – VKM
Organizata të Shqoërisë Civile - OShC

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmes projektit “Njih të drejtat e tua përmes ndihmës juridike falas”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka synuar të kontribuojë drejtpërdrejt në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë mbi të drejtat e tyre dhe si të përfitojnë nga e drejta themelore e aksesit në drejtësi përmes ndihmës juridike të garantuar nga shteti, duke u fokusuar në qytetet Librazhd, Kukës dhe Himarë. Përveç mobilizimit të të rinjve dhe përfaqësuesve të OShC-ve lokale partnere në një sërë iniciativash të mëparshme, KShH ka synuar të krijojë sinergji dhe të krijojë ura bashkëpunimi e ndërveprimi, në mënyrë që të ofrojë ndihmë juridike për kategoritë vulnerabël dhe të marginalizuara, përmes aktiviteteve të formatit “*street laë*”.

Gjatë 4 ditëve të hapura të informimit për secilin prej qyteteve, të ndërmarra nga ana e dy paraligjorëve të angazhuar në terren, u informuan dhe u ndërgjegjësuar rreth 186 qytetarë, përkatësisht 64 qytetarë në qytetin Kukës, 58 qytetarë në qytetin e Librazhdit dhe 64 qytetarë në qytetin e Himarës. Në kuadër të plotësimit të pyetësorëve të kategorizuar për qytetarët në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, banorëve iu ofrua informacion mbi kuadrin ligjor në fuqi, procedurat që duhet të ndiqen për të përfituar ndihmë juridike falas dhe u grumbullua informacion i përgjithshëm mbi qasjen e tyre në raport me institucionet publike, ndihmën juridike të garantuar nga ana e shtetit dhe anasjelltas.

Nga këta pyetësorë të plotësuar në terren, KShH vëren me shqetësim se niveli i përgjithshëm i edukimit ligjor dhe informimit mbi kuadrin ligjor në fuqi, me fokus të veçantë legjislacionin për ndihmën juridike është jo i kënaqshëm. Nga të dhënat e grumbulluara, konstatohet se mungesa e njohurive nuk është më një element i cili ndërlihet me nivelin arsimor të qytetarëve. Psh: në Bashkinë Himarë nga 64 qytetarë të intervistuar, 85.4% e tyre referojnë se kanë përfunduar studimet në arsimin e mesëm, ndërkohë që 93.3% e 60 personave që kanë zgjedhur t’i përgjigjen pyetjes mbi dijeninë për mundësinë e përfitimit të shërbimit juridik falas, referojnë se nuk kanë dijeni mbi ekzistencën e kësaj të drejte. Akoma më shqetësues është fakti se nga 64 shtetasit e përfshirë në anketim, 50% e tyre i përkasin grupmoshës 26-35 vjeç, pra pjesë e kategorisë që kanë mundësi aksesit në internet dhe kanale telekomunikimi. Pyetjes mbi angazhimin e tyre në tregun e punës kanë zgjedhur t’i japin përgjigje vetëm 52 shtetas, nga të cilët 53.8% kanë një përvojë pune 1-5 vite në fusha të ndryshme, kryesisht profesionale. Ndërveprimi i tyre me bashkë-qytetarë të ndryshëm, në funksion të punëve që kanë realizuar, ka bërë që fokusi i tyre të jetë kryesisht në garantimin e të ardhurave socio-ekonomike për veten dhe familjarët, ndërkohë që nga 61 qytetarë 85.2% e tyre janë të ndërgjegjshëm dhe i vlerësojnë njohuritë e tyre të përgjithshme mbi ligjin në kategorinë “dobët”. Mungesa e njohurive ka bërë që ata të mos iu drejtohen institucioneve publike për gjetjen e rrugëzgjidhjeve ligjore, duke bërë që ata të përfshihen në kategorinë e shtetasve të cilët reflektojnë mungesë të besimit tek institucionet publike. Nga bashkëbisedimet e realizuara në terren me ekipin e paraligjorëve rezultoi se shkaqet ndikuese në reflektimin e mungesës së besimit tek institucionet, janë të ndikueshme edhe nga vetë qytetarët, të cilët zgjedhin rrugët informale dhe “miqësore” për trajtimin e problematikave të tyre ligjore ose zgjedhin të mos e ndjekin çështjen në nivel administrativ apo gjyqësor.

Shembulli i sipërcituar pasqyron situatën në një ndër qytetet, në të cilat u shtri iniciativa e ndërmarrë nga KShH, ndërkohë që niveli i ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi kuadrin ligjor në fuqi dhe ekzistencën e të drejtës së ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti paraqitet në nivele të ngjashme jo të kënaqshme edhe për qytetet e tjera, objekt monitorimi. Por në fokus të fushëveprimit të kësaj iniciative, krahas qytetarëve, kanë qenë dhe institucionet në nivel qendror dhe në nivel vendor. Tre Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashkitë) janë treguar bashkëpunuese që në inicim të kësaj iniciative, duke shfaqur disponibilitet në realizimin e takimeve të hapura në ambientet e institucionit, sëbashku me përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Avokatit të Popullit. Në 3 Bashkitë e vendit janë ndërmarrë 12 sesione informuese dhe ndërgjegjësuuese në terren, më konkretisht 4 sesione për çdo Bashki dhe nga 2 takime me synim bashkëbisedimin me përfaqësues të institucioneve kyçe pjesë e mekanizmit të ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, si Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan.

Nga të dhënat e referuara nga ana e njësive të qeverisjes vendore, ngritja e qendrës për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas përpos prioritetit që duhej t'i ishte kushtuar nga institucionet në nivel qendror, është një planifikim i mirëpritur i cili do të lehtësonte procesin e aksesit në drejtësi të qytetarëve. Në kushtet aktuale, në mungesë të lokalizimit të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike parësore në këto qytete, qytetarëve iu nevojitet të shpenzojnë kohë, kosto financiare dhe të përshkojnë distanca relativisht të largëta pranë qendrave më të afërta ku mund të jenë pozicionuar këta ofrues, në mënyrë që të marrin një këshillim ligjor falas.

Nga ana e përfaqësuesve të Bashkive Himarë, Kukës dhe Librazhd janë ndërmarrë një sërë bashkëbisedimesh me përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, por pavarësisht vullnetit reciprok ndikimi i mungesës së kapaciteteve financiare dhe burimeve njerëzore, vlerësohet si pengesë për finalizimin e një plani konkret për ngritjen e këtyre qendrave. Nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 111/2017, KShH konstaton se departamente të caktuara pranë Bashkive objekt monitorimi si Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve ose Sektori Juridik, janë përballur me nevojën për trajtimin e ankesë/kërkesave të adresuara nga ana e qytetarëve, edhe pse ky shërbim nuk është një kompetencë e drejtëpërdrejtë të cilën ligji ua ka njohur këtyre institucioneve.

Duke qenë se shërbimet e ndihmës juridike parësore nga ofruesit e përcaktuar në ligjin nr. 111/2017, në territorin e këtyre Bashkive janë të munguara, KShH është bazuar në analizimin e të dhënave të publikuara nga vetë DNJF. Nisur nga këto të dhëna të reflektuara nga ofruesit e shërbimeve që janë të lokalizuar në qytetin më të afërt me Bashkinë objekt monitorimi, shfaqet i pamundur kategorizimi i të dhënave mbi bazën e vendbanimit/vendqëndrimit të qytetarit. Mungesa e fokusimit tek kjo e dhënë personale është ngritur si shqetësim edhe nga vetë përfaqësuesit e Gjykatave, të cilëve iu është dashur të verifikojnë manualisht nga ana e sistemit vendbanimin e palës ndërgjyqëse, në raport me fokusin e kufizuar të monitorimit që KShH zbaton.

Kjo mungesë e konstatuar, ka bërë që institucionet e sistemit të drejtësisë të referojnë të dhëna të cilat përbëjnë interes për publikun, të cilat identifikohen në kuadër të ndihmës juridike dytësore. Për shkak të ndarjes territoriale dhe Dekretit të Presidentit¹, qytetet e Librazhdit dhe Himarës nuk kanë instancë të shkallës së parë të gjyqësorit. Në mungesë të ngritjes së Gjykatave të Rretheve Gjyqësore pranë këtyre Bashkive, nga ana e KShH-së informacion statistikor dhe cilësor është kërkuar pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan dhe Vlorë. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga ana e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan, Vlorë dhe Kukës konstatohet se numri më i lartë i kërkesave të qytetarëve për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga ana e shtetit është depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, por nga ana e stafit të administratës për shkak të mbingarkesës ka qenë i pamundur identifikimi dhe kategorizimi i palëve ndërgjyqëse sipas vendbanimit/vendqëndrimit të tyre, në mënyrë që të dhëna të konkretizuara të reflektoheshin për Bashkinë Librazhd.

Faktori i ndarjes territoriale dhe mungesa e juridiksionit gjyqësor reflektohet edhe në organet proceduese, pra nga ana e Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë në Bashkitë objekt monitorimi. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga ana e Prokurorive objekt monitorimi² reflektohet se vetëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan 1 qytetar ka depozituar kërkesë për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga ana e shtetit. Ndërkohë nga ana tjetër, i njëjti organ procedues bën me dije se për periudhën Shtator 2020-Shtator 2021, 385 vendime shpërblymi janë akorduar në favor të mbrojtësve të caktuar kryesisht nga ana e prokurorëve. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para Kukës dhe Vlorë na kanë informuar se asnjë kërkesë nuk është depozituar nga ana e shtetasve. Nisur nga këto të dhëna statistikore, KShH vëren se paralelizmi i vërejtur ndërmjet procedurës që shtetasit duhet të ndjekin konformë ligjit nr. 111/2017 dhe dispozitave specifike të Kodit të Procedurës Penale, ka shfaqur konfuzitet edhe për

¹ Dekret i Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 6201, dt. 08.06.2009 "Për caktimin e kompetencave tokërsore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe të Qendrës së Ushtrimit të Veprimtarisë së secilës prej tyre".

² Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

vetë përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë, të cilët nuk reflektojnë të dhënat e kategorizuara në mënyrë të qartë sa i përket ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe mbrojtësit ligjor kryesisht të detyrueshëm për t'u caktuar bazuar në nenin 49 të K.Pr.Penale.

Duke analizuar në mënyrë të ndërlidhur dhe në koalizion qasjet e këndvështrimet e institucioneve në nivel vendor, DNJF-së dhe qytetarëve, KShH konstaton se hapa konkretë ndër-institucionalë në kuadër të bashkëpunimit dhe partneritetit duhet të ndërmerren me në fokus komunitetin dhe garantimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. KShH e vlerëson qasjen e DNJF dhe publikimin objektiv të të dhënave statistikore, të cilat me të drejtë nga njëra anë reflektojnë një punë të lavdërueshme të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe asaj dytësore, si dhe shfaqin rritje të nivelit të ndërgjegjësimit e informimit të qytetarëve të cilët përfitojnë nga e drejta e aksesit në drejtësi falas. Por nga ana tjetër, KShH sugjeron që aktivitetet konkrete duhen ndërmarrë në terren, për shkak se gjendja e reflektuar nga vetë qytetarët bazuar në të dhënat e anketimit nuk pasqyron një situatë ndërgjegjësimit dhe informimi, por një gjendje hezitimi e mosbesimi nga ana e tyre në raport me institucionet publike në nivel vendor.

Në kushtet aktuale në të cilat konstatohet se MD ka hartuar të plota aktet dytësore dhe formatet e formularëve sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2017, sugjerojmë ndërmarrjen e hapave konkretë edhe nga ana e përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë Gjykatave dhe Prokurorive, për të publikuar në faqet zyrtare institucionale formatet e formularëve të kërkesave për ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Versioni i cili do të mundësonte për qytetarët plotësimin e këtyre formateve edhe elektronikisht do të ndikonte pozitivisht në trajtimin e kërkesës dhe ofrimin e aksesit në drejtësi pa vonesa.

Për shkak të mungesës së ngritjes së qendrave për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore pranë Bashkive Kukës, Himarë dhe Librazhd, por nisur dhe mungesa e ekzistencës në territorin e këtyre Bashkive të kategorive të tjera të ofruesve të shërbimeve ligjore si organizata joqeveritare të autorizuara nga ana e MD-së ose Klinika të Ligjit pranë IAL-ve, rezulton se qytetarëve ju duhet të udhëtojnë pranë Bashkive Lezhë, Vlorë dhe Elbasan për të përfituar konsulencë juridike falas. Krahas mungesës së aksesit të menjëhershëm dhe adekuat të qytetarëve në drejtësi, në xhepat e tyre rëndon dhe kostoja financiare e transportit, por dhe koha e konsiderueshme që i nevojitet për të përfituar shërbime të ndihmës juridike parësore.

KREU I

1. OBJEKTI, QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT

1.1. Objekti i raportit

Në Dhjetor të vitit 2017 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin Nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2018. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji në drejtim të garantimit të aksesit në drejtësi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është angazhuar proaktivisht në ofrimin e opinionëve dhe sugjerimeve që në momentin e parë të hartimit të këtij projektligji.

Duke qenë një legjislacion risi, i cili solli një sërë ndryshimesh në mënyrën e perceptimit nga ana e qytetarëve, por dhe impaktin e konstatuar në procedurat si dhe mekanizmin e institucioneve përgjegjëse për ofrimin e ndihmës juridike falas të garantuar nga ana e shtetit, KShH ka monitoruar në mënyrë periodike zbatimin e këtij legjislacioni nga ana e institucioneve përgjegjëse.³

Nëpërmjet këtij raporti, KShH ka si objekt monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në 3 prej qyteteve të vendit, si Kukës, Himarë dhe Librazhd, me qëllim informimin e qytetarëve mbi rëndësinë që ka aksesin në drejtësi nëpërmjet përfitimit të shërbimeve ligjore falas nga ana e shtetit, në rast të pamundësisë ekonomike për të kërkuar mbrojtës ligjor të zgjedhur ose në rast të përfshirjes në kategoritë e veçanta vulnerabël të shoqërisë. Nisur edhe nga konkluzionet e rekomandimet e adresuara nga ana e KShH-së, nëpërmjet raporteve të mëparshme të publikuara, vlerësojmë se sensibilizimi i qytetarëve në të gjitha rajonet e vendit duhet të shërbejë si një mekanizëm i rëndësishëm për rikthimin e besimit të qytetarëve tek transparenca, llogaridhënia dhe përgjegjshmëria e institucioneve në vendin tonë.

1.2. Qëllimi i raportit

Nëpërmjet këtij Raporti, KShH synon që të kontribuojë sadopak në:

- Të identifikojë nivelin e zbatimit të ligjit nga institucionet në nivel vendor dhe qendror, si dhe të evidentojë rolin që ato luajnë në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë grupet vulnerabël dhe ato të marginalizuara.
- Evidentimin e nivelit të informimit qytetar mbi ekzistencën e këtij ligji dhe mundësitë që ai ofron.
- Evidentimin e faktorëve që krijojnë vështirësi për qytetarët në raport me zbatimin e ligjit.
- Vlerësimin e trendit të masës së qytetarëve të cilët kanë përfituar ose dëshirojnë të përfitojnë shërbime të ndihmës juridike parësore, të garantuar nga ana e shtetit.

1.3. Metodologjia e raportit

Ky raport është hartuar mbi bazën e të dhënave sasiore e cilësore përfituara në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara në terren⁴, si dhe nëpërmjet monitorimit të realizuar mbi bazën e korrespondencave zyrtare të shkëmbyera me institucionet përgjegjëse pjesë e mekanizmit të ofrimit dhe garantimit të respektimit të aksesit në drejtësi, nëpërmjet shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

³ Raport Studimor “Për aksesin në drejtësi të grupeve vulnerabël”, KShH, Shkurt 2019. Link: https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH_Shkurt-2018.pdf

Raport “Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti, në kuadër të ofrimit të ndihmës juridike parësore”, KShH, Nëntor 2019. Link: <https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2019/12/Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim--Komiteti-Shqiptar-i-Helsinkit.pdf>
Raport i Ndërmjetëm Monitorimi “Mbi ngritjen dhe funksionimin e aktorëve përgjegjës të ofrimit të ndihmës juridike parësore”, KShH, Maj 2020. Link: <https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2020/07/Mbi-ngritjen-dhe-funksionimin-e-aktor%C3%ABve-p%C3%ABrgjegj%C3%ABs-t%C3%AB-ofrimit-t%C3%AB-ndihm%C3%ABs-juridike-par%C3%ABsore.pdf>

⁴ Ekipi i përbërë nga anëtarë të stafit të KShH-së dhe paralogjorë të angazhuar kanë ndërmarrë takime bashkëbiseduese me përfaqësuesit e institucioneve publike, takime me qytetarët në terren për të diskutuar mbi këndvështrimin e tyre në raport me marrëdhënien komunitet-institucion, si dhe kanë ofruar ndihmë juridike falas parësore nëpërmjet këshillimit të qytetarëve në terren.

1.3.1. FAZA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Në mbledhjen e të dhënave, ekspertët kanë përdorur instrumente të ndryshme kërkimi, sipas nevojës dhe qëllimeve të këtij raporti. Kështu, si mjete kërkimore për mbledhjen e të dhënave kanë shërbyer *shkëmbimi i korrespondencave zyrtare me institucionet përgjegjëse, si dhe ndërmarrja e misioneve të monitorimit në terren, të cilat konsistojnë në realizimin e intervistave të individualizuara me përfaqësuesit e institucioneve publike si dhe plotësimin e pyetësorëve gjatë bashkëbisedimit me qytetarët.*

Në kuadër të mbledhjes së të dhënave janë zhvilluar një sërë aktivitetesh, Bashkitë Kukës, Himarë dhe Librazhd:

- Me synim grumbullimin e informacionit bruto, duke analizuar dhe krahasuar këndvështrimet dhe opinionet e adresuara nga ana e përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse në nivel vendor, KShH realizuar 4 tryeza të rrumbullakëta konsultuese. Këto tryeza kanë bërë bashkë përfaqësues të Njësive të Qeverisjes Vendore (Bashkive); Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas; Avokatit të Popullit; Gjykatës së Shkallës së Parë etj.
- Njëpërmjet realizimit të 12 sesioneve të informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut, si dhe ofrimin paralelisht të shërbimeve të ndihmës juridike parësore (3 vizita janë realizuar në secilin qytet), KShH ka bërë të mundur:
 - a) Ofrimin e ndihmës juridike parësore, në trajtën e këshillimeve ligjore për 160 qytetarë, ku fokusi primar i paraligjorëve ka qenë orientimi i tyre mbi procedurën e aplikimit për të përfituar ndihmë juridike sipas parashikimeve të ligjit Nr. 111/2017.
 - b) Rreth 180 qytetarë kanë bashkëpunuar në plotësimin e pyetësorëve të individualizuar, duke krijuar premisa për grupin e vëzhguesve dhe paraligjorëve për të vlerësuar nivelin e njohurive të tyre mbi ndihmën juridike të garantuar nga ana e shtetit.
- Grumbullim informacioni njëpërmjet shkresave zyrtare adresuar Njësive të Qeverisjes Vendore (Bashkive), Gjykatave të Rretheve Gjyqësore të juridiksionit të zakonshëm, si dhe Prokurorive pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, me synim evidentimin e të dhënave statistikore lidhur me qytetarët që kanë zgjedhur t’i drejtohen këtyre institucioneve për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga ana e shtetit.

1.3.2. FAZA E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE DHE HARTIMI I RAPORTIT

Gjatë fazës së përpunimit të të dhënave të grumbulluara njëpërmjet aktiviteteve proaktive të realizuara në terren, u përdor metoda sasiore e cilësore në përpunimin e të dhënave dhe gjetjeve të monitorimit. Njëpërmjet metodës sasiore u matën karakteristikat dhe u ilustruan faktet në terma numerikë e statistikorë. Ndërkohë, të dhënat cilësore u evidentuan për t’u interpretuar në momentin e hartimit të raportit. Përgjatë këtij raporti janë aplikuar e ndërthurur disa metoda si vijojnë: metoda e hulumtimit të dispozitave juridike, metoda analitike, metoda induktive, metoda krahasuese, metoda statistikore dhe metoda përshkruese.

Në fokus të procesit të grumbullimit dhe përpunimit të informacioneve ka qenë garantimi i saktësisë dhe objektivitetit të tij për të arritur në produktin final që është ky raport, i cili do të sjellë një pasqyrë të situatës së ndihmës juridike falas në praktikë në Bashkitë Kukës, Himarë dhe Librazhd.

2. VËSHTRIM I SHKURTËR I LIGJIT NR. 111/2017 “PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI”

Më datë 14.12.2017 është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Ky ligj hyri në fuqi më 1 qershor të vitit 2018.

Sipas përcaktimeve të ligjit, “Ndhimë juridike” është “shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara dhe për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantohen dhe financohen nga shteti”.⁵ Në objekt të ligjit qëndron përcaktimi i formave, kushteve, procedurave dhe rregullave për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.⁶

Ndihma juridike që ky ligj mundëson për qytetarët jepet në disa forma:⁷

- *Ndhimë juridike parësore*, e cila kryesisht përfshin dhënien e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, dhënia e këshillimit, përfshirë edhe dhënien e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve. Në këtë formë ndihme juridike përfshihet edhe dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.⁸
- *Ndhimë juridike dytësore*, përbën formën e dytë të asistencës të garantuar nga ky ligj. Në të përfshihet shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën, përfshirë edhe ofrimin e këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.⁹
- *Përrjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore dhe përrjashtimi nga detyrimi për të para paguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit*, përbëjnë formën e tretë, të parashikuar nga ligji për dhënien e ndihmës juridike.

E gjithë struktura institucionale dhe normative që ky ligj parashikon ka si qëllim të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë. Pjesë e qëllimit integral të ligjit është edhe sigurimi, mirë-organizimi, mirë-administrimi dhe mire-funksionimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike me qëllim sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive.¹⁰

Përfituesit e ndihmës juridike janë ndarë në disa kategori sa më poshtë:

- a) shtetasit shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt;
- c) shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi, që hyjnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose bazuar në parimin e reciprocitetit;
- ç) azilkërkuesit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.¹¹

Ligji parashikon kategori të veçanta të përfituesve të ndihmës juridike me qëllim ofrimin e ndihmës juridike, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre, personave të mëposhtëm:

- a) viktimave të dhunës në familje;

⁵ Neni 3 pika a, e Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

⁶ Neni 2 i Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

⁷ Neni 5 i Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

⁸ Neni 3 pika b e Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

⁹ Neni 3 i Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

¹⁰ Neni 2 i Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

¹¹ Neni 10 i Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

- b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.¹²

Ndërkohë ligji kategorizon edhe përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme, ku të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile¹³.

MONITORIMI I ECURISË SË MIRATIMIT TË AKTEVE NËNLIGJORE DHE PËRGJEGJËSISË SË INSTITUCIONEVE PËRKATËSE

Pas hyrjes në fuqi të ligjit në Qershor 2018, rezulton se me disa vonesa, Ministria e Drejtësisë (MD) ka hartuar dhe miratuar të plotë aktet nënligjore dhe formularët e kërkuar sipas ligjit nr.111/2017, që i janë nënshtruar fazës së konsultimit publik me grupet e interesit dhe marrjes së mendimit të disa institucioneve bashkëvepruese me MD.

Hyrja në fuqi e këtij ligji solli shfuqizimin e Ligjit të mëparshëm nr.10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar. Që në krye të herës vlen të theksojmë se gjatë monitorimit të realizuar nga KShH në vitin 2019 rezultoi se formularët e kërkesës për ndihmë juridike parësore dhe vetë-deklarimit për ndihmë juridike parësore nuk gjendeshin të publikuara në format lehtësisht të aksesueshëm online.¹⁴ Gjatë monitorimit online të faqeve zyrtare të MD dhe të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (DNJF) konstatohet se ky rekomandim i adresuar është përmbushur në mënyrë të plotë nga ana e këtyre dy institucioneve përgjegjëse, të cilat kanë marrë masa konkrete për publikimin online të këtyre formateve.¹⁵¹⁶

Në vazhdimësi, MD ka miratuar listat e ofruesve të ndihmës juridike dytësore falas, udhëzimet e nevojshme për procedurat e kërkimit të ndihmës juridike falas, si edhe formularët e aplikimit dhe formularët e vetëdeklarimit, sa më poshtë:¹⁷

- [Lista e DNJF Avokatët që kanë lidhur kontratë për vitin 2021](#)
- [Udhëzim i Përbashket për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatisë që ofrojnë Ndihmë Juridike Falas](#)

¹² Neni 11 i Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

¹³ Neni 12 i Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

¹⁴ Ky rekomandim i KShH iu adresua Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet Raportit të Ndërmjetëm të Monitorimit më datë 4 Korrik 2019.

¹⁵ <http://drejtesia.gov.al/ndihma-juridike-e-garantuar-nga-shteti/>

¹⁶ <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/legjislacion/>

¹⁷ Link aksesi <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/ndihma-juridike-paresore/>

- [Udhëzim i Përbashkët Rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të Ndhmës Juridike Dytësore në proceset civile dhe administrative](#)
- [Lista e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore per vitin 2020](#)
- [Lista e avokateve te ndihmes juridike](#)
- [Formular Ndhma Juridike Dytësore](#)
- [Formular Perjashtimi nga Tarifat Gjyqësore](#)
- [Formular Vetedeklarim kategorite e vecanta](#)
- [Formular Vetedeklarim te ardhura pasuri](#)
- [Regjistri i kerkesave dhe vetedeklarimeve](#)
- [Regjistri i OJF qe orojne ndihme juridike paresore](#)
- [Ankim kunder vendimit ND](#)
- [Formular Ndhma juridike paresore](#)

Në vijim të monitorimit online të realizuar, KShH ka konstatuar me shqetësim se formatet e formularëve të kërkesave specifike, të hartuara në zbatim të akteve nënligjore, nuk gjenden të publikuara në faqen zyrtare të asnjë prej institucioneve pjesë e mekanizmit të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas, në nivel vendor.

Në përputhje me nenin 6 gërma ç) të ligjit nr. 111/2017, Gjykatat kompetente janë ndër institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike. KShH e vlerëson si pozitiv modelin e implementuar në faqen zyrtare (ëbsite) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, pranë së cilës shqyrtohen çështje me palë ndërgjyqëse banorët e Bashkisë Librazhd,¹⁸ në të cilin referohet me anë të link lista e avokatëve të ndihmës juridike dytësore. Ndërkohë që në faqen zyrtare të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë gjendet i publikuar vetëm Urdhëri nr. 1284/3, dt. 16.03.2005 “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike” të Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë¹⁹, një akt nënligjor ky tashmë i përditësuar nëpërmjet Udhëzimit të Përbashkët nr. 17, dt. 05.08.2020 “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve, që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”²⁰ dhe Udhëzimit të Përbashkët të MD dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 18, dt. 05.08.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”²¹. Gjithashtu, në faqen zyrtare të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nuk gjenden të publikuara as formate të formularëve që nevojitet të plotësohen nga ana e qytetarëve për të përfituar shërbime të ndihmës juridike dytësore.

Mungesë të publikimit të këtyre formateve të formularëve KShH e vëren edhe në faqet zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë²² dhe Kukës²³. Gjithashtu, një tjetër element i rëndësishëm i cili lidhet me shërbimet e ndihmës juridike dytësore konsiston në përjashtimin e kategorisë së shtetasve të përfshirë nga ligji nr. 111/2017, nga pagimi i taksave dhe tarifave gjyqësore. Në faqet zyrtare të Gjykatave të Rrethëve Gjyqësore objekt monitorimi vërejmë se në seksionin e tarifave gjyqësore, nuk gjendet i publikuar as elaborimi i kategorisë së shtetasve përfitues²⁴ dhe as formati i formularit të vetë-deklarimit.

Në ligjin nr. 111/2017 nuk pasqyrohet një detyrim ligjor i drejtpërdrejtë ndaj Prokurorive pranë Gjykatave të Rrethëve Gjyqësore, në mënyrë që ura të mirëfillta bashkëpunimi të vendosen në rang ndër-

¹⁸ <http://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-rrethit-elbasan/gjykata/avokatet-e-gjyqesore/>

¹⁹ <http://eëë.dhka.org.al/index.php/legjislacioni/tarifa-te-shperblimit-te-avokateve-per-dhenien-e-ndihmes-juridike>

²⁰ <https://ndihmajuridike.gov.al/ep-content/uploads/2020/09/Udh%C3%ABzim-i-p%C3%ABrbashk%C3%ABt-i-ministrit-t%C3%ABDrejt%C3%ABsis%C3%AB-dheKryetarit-t%C3%ABDhom%C3%ABs-s%C3%AB-Avokatis%C3%AB-s%C3%AB.pdf>

²¹ <https://ndihmajuridike.gov.al/ep-content/uploads/2020/09/Udh%C3%ABzim-i-p%C3%ABrbashk%C3%ABt-i-ministrit-t%C3%ABDrejt%C3%ABsis%C3%AB-dhe-i-ministrit-t%C3%AB-Financave-dhe-Ekonomis%C3%AB-nr.-18-dat%C3%AB-5.8.pdf>

²² <http://gjykata.gov.al/rrethi-vlor%C3%AB/gjykata-e-rrethit-vlor%C3%AB/njoftime-t%C3%AB-tjera/>

²³ <http://gjykata.gov.al/rrethi-kuk%C3%AB/gjykata-e-rrethit-kuk%C3%AB/gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/>

²⁴ Një model pozitiv është kategorizimi i publikuar nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/kategorite-qe-perfitojne/>

institucional me Drejtorinë e Ndhmës Juridike. Pavarësisht kësaj situatë, KShH vlerëson se detyrueshmëria lind në zbatim të Vendimit nr. 231 i Këshillit të Prokurorisë, datë 12.11.2019 “Për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proces penal”. Bazuar në nenin 38 të këtij vendimi, në vijim të neneve 49/7 dhe 49/a të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria përmbush shërbimin e ndihmës juridike në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme. Në vitin 2021, faqja zyrtare e Prokurorisë së Përgjithshme u përditësua duke reflektuar në seksion të posaçëm dhe të dhëna mbi Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe atyre të Apelit.²⁵ Në faqet zyrtare të Prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Kukës, Vlorë dhe Elbasan nuk konstatohen që të jenë publikuar të dhëna mbi ndihmë juridike dytësore të ofruar qytetarëve në zbatim të dispozitave të sipërcituara, ndërkohë që as formatet e formularëve për të ofruar këtë formë të ndihmës juridike nuk gjenden të publikuara as në faqen zyrtare të këtyre institucioneve.²⁶ Gjithashtu, me shqetësim KShH vëren se as në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme por as në atë të DNJF nuk konstatohet që të jenë ndërmarrë tryeza të përbashkëta konsultimi ndër-institucional, me qëllim diskutimin ndërmjet pengesave dhe vështirësive që hasen në praktikë, informacion i cili mund të shërbejë dhe për rritjen e numrit të të miturve ose personave pjesë e komuniteteve të marginalizuara në vend, të cilët mund të përfitojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në kuadër të mbrojtjes së detyrueshme.

Në kuadër të reformës për modernizimin e shërbimeve publike në Shqipëri prej muajit Nëntor 2018 është bërë e mundur krijimi i Qendrave të Integruara me një Ndalesë (ADISA) pranë Bashkive Kukës dhe Librazhd,²⁷ si dhe prej muajit Gusht 2021 në Bashkinë Himarë. Pranë këtyre qendrave raportohet se ofrohen një sërë shërbimesh ligjore, të natyrës së ndihmës juridike parësore. Gjithashtu, edhe në nivel qeveritar konstatohet se shteti shqiptar ka ndërmarrë një sërë masash për trajtimin e kërkesë-ankesave të qytetarëve nëpërmjet ngritjes së Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.²⁸ Me hyrjen në fuqi në Dhjetor 2021 të ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”²⁹, vërehet se parashikohet mundësia e zbatimit të dispozitave të bashkëqeverisjes edhe për çështjet që lidhen me veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore, nëse këto të fundit lidhin marrëveshje për këtë qëllim me Agjencinë. Në respektim të nenit 40 pika 3 të ligjit të hyrë në fuqi, rezulton se “*gjatë shqyrtimit të ankesës, nëse Agjencia konstaton se përtej shpjegimeve të paraqitura nga organi kompetent, trajtimi i çështjes kërkon këshillimin ligjor të ankuesit për rastin, ajo mund ta referojë/ta delegojë atë te Drejtoria e Ndhmës Ligjore Falas, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, e cila e shqyrton kërkesën në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti*”.

Gjatë monitorimit të realizuar nga KShH rezulton se në faqet zyrtare të Bashkive objekt monitorimi, por edhe në ato të ADISA, nuk gjenden të publikuara asnjë format i formularëve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, të cilat mund të ndihmonin qytetarët që të aksesonin në këto shërbime. Në pamje të parë, siç dhe qytetarët shpesh referojnë konfundim gjatë bashkëbisedimeve, shërbimet që ofrohen nga ana e këtyre institucioneve ngjan e mbivendosur, por KShH vlerëson se përfshirja e disa aktorëve kyç në ofrimin e shërbimeve të kësaj natyre shërbejnë pozitivisht në garantimin e aksesit të qytetarëve në drejtësi.

²⁵ https://eëe.pp.gov.al/Prokurorite_prane_Gjykates_se_Shkalles_se_Pare/

²⁶ Ndhimja juridike dytësore është ai lloj shërbimi ligjor që ofrohet për problematikat zgjidhja e të cilave mund të realizohet vetëmnëpërmjetgjykatësapo prokurorisë. Manual “Si të përfitojmë ndihmë juridike falas”, DNJF, 2020. Link: <https://ndihmajuridike.gov.al/ep-content/uploads/2020/08/Manual-Ndihma-Juridike-NEE.pdf>

²⁷ <https://eëe.adisa.gov.al/kolokime-adisa/>

²⁸ Është ngritur dhe ka funksionuar bazuar në VKM nr. 638, datë 6.11.2017.

²⁹ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/11/04/107/b3a205b3-5e41-4e47-acbf-f68aa23320d3>

KREU II

1. QASJA INSTITUCIONALE NË RAPORT ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nëpërmjet takimeve të realizuara me përfaqësuesit e institucioneve publike dhe grumbullimit të informacionit nëpërmjet korrespondencës zyrtare, është synuar shkëmbimi i opinioneve dhe sugjerimeve mbi situatën aktuale me të cilat institucionet përballen, vështirësitë dhe pengesat e konstatuara si dhe masat që ata sugjerojnë si të domosdoshme për t'u ndërmarrë me qëllim garantimin e të drejtës së qytetarëve për të aksesuar sistemin e drejtësisë, nëpërmjet ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit.

1.1. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

KShH e vlerësoi si të domosdoshme marrjen e informacionit të kategorizuar mbi këndvështrimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (DNJF) mbi situatën e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas në Bashkitë Himarë, Kukës dhe Librazhd.

KShH ju drejtua me anë të një kërkesë zyrtare në rrugë elektronike këtij institucioni.³⁰ Për shkak të mungesës së ofrimit të informacionit të plotë nga ana e DNJF-së, sipas kërkesës së adresuar dhe brenda afateve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, KShH vuri në lëvizje Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,³¹ pas ndërhyrjes së të cilit u bë e mundur që të njihemi me informacionin e plotë mbi secilën prej pyetjeve të adresuara.

Nga informacioni i bërë publik nga DNJF-ja, nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 111/2017 rezulton se në rang vendi kanë përfituar ndihmë juridike parësore 10.373 qytetarë, ndërkohë përfaqësim në gjykatë me avokatë të garantuar nga shteti përmes sistemit të ndihmës juridike dytësore kanë përfituar 761 qytetarë. Për vitin 2022, është referuar nga vetë DNJF, se prioritet mbetet ndër të tjera hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në zonat e pambuluara me ofrues të shërbimit, siç janë Kukës, Korçë, Elbasan dhe Berat. Sa i përket qytetarëve të Bashkisë Himarë, referohet se ata e kanë të mundur që të drejtohen për të aksesuar shërbime të ndihmës juridike parësore pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Vlorë. Pra qytetarëve ju nevojitet të përshkojnë një distancë automobilistike rreth 70 km, ose rreth 2 orë për të aksesuar drejtësinë.

Pranë Njësisë të Qeverisjes Vendore (Bashkive) objekt monitorimi, vetëm gjatë vitit 2021 ka qenë e mundur që nga ana e DNJF-së t'ju vihen në dispozicion materiale informuese dhe promovuese, si dhe të informohen mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, dhe vendndodhjet e ofruesve të shërbimit.

Ndërkohë në vitin 2020 rezulton se ndërmjet DNJF dhe Gjykatave të Shkallës së Parë Elbasan, Vlorë dhe Kukës, janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.³² Duke qenë se në Bashkitë Librazhd, Kukës dhe Himarë nuk rezultojnë të ngritura konkretisht Qendra për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, DNJF informon se sa kohë ka realizuar ndërgjegjësimin dhe informimin pranë këtyre Bashkive, çdo qytetar orientohet të drejtohet pranë ofruesve më të afërt të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit.

³⁰ Email dt. 10 Nëntor 2021 “Kërkesë për informacion”

³¹ Shkresë e KShH nr. Prot. 867, dt. 17.12.2021 “Ankim administrativ lidhur me mosdërgimin e informacionit të kërkuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas”

³² Marrëveshja nr. 476/2 prot., dt. 27.10.2020, me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë
Marrëveshja nr. 457/1 prot., dt. 27.10.2020, me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës
Marrëveshja nr. 470/1 prot., dt. 27.10.2020, me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan




Figura 1- Të dhëna zyrtare të përpunuara nga informacioni i publikuar në adresën e DNJF

<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/publikime/>

Nga të dhënat zyrtare të publikuara nga DNJF në Raportet e analizave statistikore për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga ana e ofruesve të shërbimeve mbi baza mujore është e pamundur që të identifikohen të dhëna të kategorizuara mbi përfituesit e këtyre shërbimeve banues në Bashkitë Himarë, Librazhd dhe Kukës. Këto mungesa vijnë për faktin se ofruesit e shërbimeve të vendosura pranë vendndodhjes më të afërt të këtyre qytetarëve nuk kanë përcjellë të dhëna mbi vendbanimin e përfituesve.

Nga të dhënat mujore të pasqyruara nga ana e DNJF-së vërehet një numër në rritje i shtetasve që i adresohen ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike për të përfituar nga kjo e drejtë, një indikator ky i cili në këndvështrimin e DNJF-së reflekton një tregues në rritje të informacionit të qytetarëve sa i takon ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Rezulton se gjatë vitit 2021, DNJF ka zhvilluar/marrë pjesë në rreth 120 aktivitete të realizuara në Bashki të ndryshme të vendit, ndër të cilat dhe Bashkitë objekt monitorimi.³³

1.2. Qasja e institucioneve në nivel vendor në qytetin e Librazhdit

1.2.1. BASHKIA LIBRAZHD

Edhe pse në planet e DNJF-së për vitin 2022 rezulton i evidentuar planifikimi për ngritjen e qendrave për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas në qytetet Elbasan dhe Kukës, nga ana e Bashkisë së Librazhdit vlerësohet si e domosdoshme ngritja e një qendra të kësaj natyre dhe në këtë qytet. Kjo nevojë rezulton të jetë përcjellë edhe nëpërmjet bisedimeve që përfaqësuesit e Bashkisë kanë realizuar me DNJF-në dhe me organizata kombëtare e ndërkombëtare të akredituara për dhënien e ndihmës juridike falas, por deri më tani nuk rezulton të jetë konkretizuar një plan final për mundësinë e ngritjes së një zyre/qendre.³⁴

Bazuar në bashkëbisedimet e realizuara në terren, por edhe duke iu referuar informacionit zyrtar të përcjellë, KShH ka konstatuar se punonjësit e departamentit ligjor pranë Bashkisë Librazhd luajnë një rol proaktiv në informimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre, udhëzimin dhe asistimin e tyre për t'ju drejtuar ofruesve të shërbimeve ligjore falas, të miratuar nga ana e MD-së.

Vetë Bashkia ka evidentuar se rastet e dhunës në familje të cilat paraqiten nga ana e qytetarëve pranë institucionit janë në një masë të madhe, fakt ky i cili ka bërë që ndihma e parë ligjore t'ju ofrohet viktimave të dhunës nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, në bashkëpunim me Sektorin Juridik.

³³ Aktivitet dt. 09.01.2021: Sesion Informues për ndihmën juridike të garantuar nga shteti pranë Bashkisë Elbasan

Aktivitet dt. 22.06.2021: Sesion Informues për ndihmën juridike të garantuar nga shteti pranë ADISA Elbasan

Aktivitet dt. 20.12.2021: Sesion Informues për ndihmën juridike të garantuar nga shteti pranë Bashkisë Kukës

Aktivitet dt. 23.09.2021: Takim në Qytetin e Vlorës midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, punonjëseve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë, përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimit Social Bashkia Vlorë, Qendra Psiko-Sociale "Vatra", Drejtorja Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorja Rajone e Punesimit, Drejtorisë Vendore të Policisë së dhe Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë etj.

³⁴ Shkresë nr. 5914/1 prot., dt. 15.11.2021 "Kthim përgjigje" përcjellë nga Bashkia Librazhd


1.2.2.GJYKATA E RREHIT GJYQËSOR ELBASAN DHE PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

Në mungesë të ngritjes dhe funksionimit të një Gjykate të juridiksionit të zakonshëm në qytetin e Librazhdit, si dhe prokurorisë respektive, KShH iu drejtua me anë të një kërkesë zyrtare për marrje informacioni institucionit më të afërt për dhënien e drejtësisë dhe ushtrimin e të drejtës për procedimin penal të shtetasve, të lokalizuara në Bashkinë Elbasan.



Figura 2- Të dhëna statistikore të publikuara nga DNJF

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan³⁵ jemi informuar se në total gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2020 Gjykata ka shqyrtuar 28 kërkesa të depozituara për ndihmë juridike dytësore, ndërkohë gjatë periudhës Janar-Shtator 2021 vërehet se 13 kërkesa janë shqyrtuar nga ana e Gjykatës. Të dhënat statistikore evidentojnë se jo në çdo rast kërkesat janë pranuar nga ana e Gjykatës.



³⁵ Shkresë nr. 107417 prot., dt. 17.11.2021 “Kthim përgjigje” përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan




Figura 3- Të dhëna statistikore të përpunuara mbi informacionin e përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Nga këto të dhëna statistikore të vëna në dispozicion nga ana e Gjykatës nuk ka qenë e mundur që të evidentohen shkaqet të cilat kanë detyruar Gjykatën për të rrezuar kërkesën e depozituar nga ana e qytetarit për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga ana e shtetit.

Sa i përket palëve ndërgjyqëse me banim në Bashkinë Librazhd, të cilët kanë depozituar kërkesë për të përfituar ndihmë juridike dytësore, për vitin 2020 rezulton se vetëm 1 kërkesë është shqyrtuar nga ana e Gjykatës me këtë objekt, ndërkohë gjatë vitit 2021 janë shqyrtuar 3 kërkesa të depozituara nga ana e qytetarëve. Një ndër problematikat e evidentuara nga ana e përfaqësuesve të Gjykatës, e cila ka ndikuar dhe në ofrimin e informacionit është mungesa e evidentimit të të dhënave mbi vendbanimin e palëve ndërgjyqëse në databazën e vendimmarrjeve gjyqësore, duke bërë që stafi përgjegjës t'i përpunojë këto të dhëna në mënyrë manuale. Gjithashtu, në Analizat Statistikore mujore të publikuara nga ana e DNJF-së reflektohen të dhëna mbi ndihmën juridike dytësore, sa i përket vendimeve gjyqësore të dhëna nga ana e Gjykatave në rang vendi.³⁶ Nga të dhënat statistikore reflektohet se në 9 mujorin e parë të vitit 2021 ka një rritje të numrit të përfituesve të cilët kanë kërkuar nga ana e Gjykatës garantimin e ofrimit të ndihmës juridike dytësore falas.

Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan rezulton se pranë organit procedues brenda periudhës Shtator 2020-Shtator 2021 është depozituar vetëm një kërkesë nga një qytetar për ndihmë juridike falas. Qytetari është identifikuar si banor i fshatit Borovë Steblevë të Bashkisë Librazhd. Nga ana e Prokurorisë, qytetari është adresuar për depozitim të kërkesës për të përfituar ndihmë juridike dytësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ndërkohë i lartë vërehet se është numri i mbrojtësve të caktuar kryesisht nga ana e Prokurorisë, më konkretisht në 385 raste ata kanë

³⁶ Analiza statistikore të aksesueshme në link: <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/publikime/>

përfaqësuar interesat ligjore të shtetasve. Edhe gjatë vizitave në terren është konstatuar se në ambientet e jashtme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan janë afishuar poster informues për ofrimin e ndihmës juridike falas dhe numra kontakti lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët, të cilët dëshirojnë të përfitojnë nga këto shërbime që ofrohen nga qendra e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore e cila është e vendosur pranë Bashkisë. Gjithashtu, pranë Prokurorisë konstatohet si pozitiv roli proaktiv i përcaktuar si kompetencë e Koordinatorit për Asistencën ndaj Subjekteve me Status të Posaçëm, në lëmin e të cilëve përfshihen: viktimat e krimit, në veçanti për të miturit, viktimat e dhunës në familje, abuzimit seksual dhe përdjekjes, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe viktimat me paaftësi fizike dhe intelektuale, duke pasur parasysh moshën dhe situatën specifike; viktimat e procesit të drejtësisë penale etj.

Në analizë të informacioneve të përcjella nga ana e institucioneve publike, rezulton se vlerësimi i përgjithshëm mbi nivelin e njohurive që qytetarët disponojnë lidhur me aksesin në ndihmë juridike të garantuar nga ana e shtetit nuk është e njëjtë. Nga ana e Bashkisë Librazhd evidentohet se *“njohuritë e qytetarëve në lidhje me aksesin në gjykatë nëpërmjet ndihmës juridike falas janë mesatare, ku kanë dijeni të përcipta dhe kanë nevojë për këshillim/orientim konkret”*, një përcëptim i cili është i ngjashëm me atë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan e cila ka ndarë opinionin e saj, sipas të cilit *“nga një vlerësim i përgjithshëm mund të themi që qytetarët nuk kanë informacion dhe njohuri për akses për ndihmë juridike falas të garantuar nga shteti. Për rrjedhojë ata hasin vështirësi në plotësimin e formularëve”*.³⁷ Vetë marrëdhënia e bashkëpunimit dhe ndërveprimit nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan me Qendrën për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore vlerësohet frytdhënëse, por nga ana e institucionit procedues kërkohet më shumë informacion mbi shërbimet që ofrohen. Gjithashtu, përfaqësuesja e organit procedues e fokuson përmirësimin e bashkëpunimit ndër-institucional duke iu vënë në dispozicion nga ana e Qendrës edhe lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dyësore falas. Kjo kërkesë nga ana e KShH-së vlerësohet e pamundur që të përmbushet nga ana e Qendrës, e cila bazuar në nenin 3 gërma d) të ligjit nr. 111/2017 është një njësi e specializuar për dhënie të ndihmës juridike parësore, e organizuar si *“njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”*, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Kjo kërkesë në këndvështrimin e KShH-së ngre premisa për mungesën e bashkëpunimit e konsolidimit të koordinimit ndërmjet këtyre dy institucioneve me qëllim përcaktimin e mekanizmit pranë të cilit mund të merret një informacion i kësaj natyre, si dhe rolin e DNJF-së dhe të Qendrës për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore.

1.3. Qasja e institucioneve në nivel vendor në qytetin e Himarës

1.3.1. BASHKIA HIMARË

Gjatë bashkëbisedimeve të realizuara me përfaqësues të Bashkisë Himarë është konstatuar një qasje e përgjithshme e hapur në raport me qytetarët dhe me ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, të cilët janë të vendosur në Vlorë si juridiksioni më i afërt. KShH konstatoi se dhe përfaqësuesit e Bashkisë, njëjtë me të dhënat e elaboruara në kreun vijues mbi anketimet në të cilat u përfshinë qytetarët, reflektojnë qasjen se qytetarët e kanë të domosdoshme ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike ligjore, ndërkohë që masa konkrete është e nevojshme që të ndërmerren për ofrimin e këtyre shërbimeve nga ana e ofruesve të organizatave joqeveritare që mund të jenë të lokalizuara në territorin e kësaj Bashkie. Kjo zgjidhje do të reduktonte kostot financiare, por edhe do të mundësonte aksesin e qytetarëve në drejtësi brenda afateve të arsyeshme, pasi në çdo rast kërkesat e qytetarëve nuk identifikohen si kërkesa për ndihmë juridike dyësore për të cilat është i nevojshëm akses i tyre pranë organeve proceduese. Nga ana e Bashkisë Himarë nuk disponohen të dhëna sa i përket shërbimeve të ndihmës juridike parësore, për shkak se juridiksioni gjyqësor është pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

³⁷ Email i dt. 17.11.2021 i përfaqësueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

1.3.2.GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË DHE PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR VLORË

Në rrugë zyrtare³⁸, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë na ka informuar se për periudhën Shtator-Dhjetor 2020 janë shqyrtuar 12 kërkesa për ndihmë juridike falas, ndërkohë që gjatë periudhës Janar-Shtator 2021 konstatohen 50 kërkesa të regjistruara. Pra në total gjatë periudhës Shtator 2020-Shtator 2021, pranë kësaj Gjykate janë regjistruar 72 kërkesa aplikim për ndihmë juridike të garantuar nga shteti.

Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në kushtet e mbingarkesës ka qenë e pamundur që




Figura 4: Të dhëna statistikore të përpunuara nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

të na referohen të dhëna të kategorizuara mbi vendbanimin e palëve ndërgjyqëse, për shkak të ndërhyrjes manuale që është e nevojshme që të realizohet nga administrata në sistemin ICMIS.³⁹ Në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet Gjykatës dhe Qendrës për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, konstatojmë se ura të mirëfillta bashkëpunimi nuk janë vendosur, ndërkohë që tryeza të përbashkëta konsultimi e diskutimi është e nevojshme që të ndërmerren. Nga ana tjetër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë na ka informuar se asnjë kërkesë për të përfitur ndihmë juridike të garantuar nga shteti nuk është depozituar pranë këtij institucioni.⁴⁰

³⁸ Shkresë nr. 1790 prot., dt. 11.11.2021 "Kthim përgjigje" lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

³⁹ E-mail i dt. 16.11.2021 "Kërkesë për informacion".

⁴⁰ Shkresë nr. 13846/1 prot.,dt. 15.12.2021 "Dërgim informacioni"

Në raport me të dhënat statistikore të përcjella nga ana e institucioneve proceduese dhe të sistemit gjyqësor konstatohet se ato të vendosura në juridiksionin gjyqësor të Bashkisë Vlorë kanë trajtuar numrin më të lartë të kërkesave të depozituara nga ana e qytetarëve sa i përket ndihmës juridike të garantuar nga shteti.




Figura 5: Të dhëna statistikore të përpunuara nga Analizat Statistike të publikuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

Gjatë informimit të Kuvendit nga ana e anëtarëve të Rrjetit për ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimtari të Strategjisë të Edukimit Ligjor të Publikut (SELP), rezulton e raportuar nga përfaqësuesit e DNJF-së se përgjatë periudhës janar-mars 2021 me mbështetjen e UNDP-së është bërë e mundur edhe hapja dhe rivitalizimi i 3 qendrave të reja të ndihmës juridike parësore Fier-Vlorë dhe Dibër.⁴¹ Nisur nga të dhënat statistikore të bëra publike nga DNJF, nëpërmjet analizave mujore dhe vjetore, KShH konstaton se Qendra për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore në Vlorë ka ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore për rreth 127 qytetarë, gjatë periudhës Mars-Shtator 2021.

1.4. Qasja e institucioneve në nivel vendor në qytetin e Kukësit

1.4.1. BASHKIA KUKËS

Njësoj me situatën e reflektuar edhe në 2 Bashkitë e tjera objekt monitorimi rezulton se dhe nga ana e Bashkisë Kukës vlerësohet si e domosdoshme marrja e hapave konkrete për hapjen dhe vënien në funksion të Qendrës për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore pranë kësaj Bashkie. Nga ana e Bashkisë evidentohen raste të rralla të qytetarëve që i drejtohen njësisë së qeverisjes vendore për të kërkuar konsulencë juridike, ndërkohë që numrin e papërfillshëm të qytetarëve përfaqësuesit e Bashkisë e lidhin me nivelin e njohurive të qytetarëve.⁴² Nga ana e kësaj Bashkie raportohet se fushata të ndryshme sensibilizuese me fokus rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushteve për përfitimin e saj, janë ndërmarrë në bashkëpunim me administratorët e njësive administrative, punonjësve të Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Kujdesit Shoqëror, si dhe përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme si dhe zyrës së Avokatit të Popullit.

Nga bashkëbisedimet e realizuara me përfaqësuesit e institucioneve publike në Kukës, përkatësisht përfaqësues të Bashkisë, zyrës së Avokatit të Popullit në nivel vendor, përfaqësues të organizatave joqeveritare aktive në këtë zonë etj., KShH ka konstatuar se zyra e Avokatit të Popullit dhe ADISA janë dy

⁴¹ Procesverbal i Kuvendit mbi Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut, mbledhje e datës 26.05.2021, Fq. 12. Link: <https://eëë.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/selp/20210604113205Procesverbal%20SELP-26.5.2021.pdf>

⁴² Shkresë nr. 5112/1 prot., dt. 15.11.2021 "Kthim përgjigje" të Bashkisë Kukës

mekanizmat kyçë pranë të cilave institucionet publike orientojnë qytetarët për të marrë shërbime të ndihmës juridike parësore. Vetë përfaqësuesit e këtyre institucioneve reflektojnë nivel të ndryshëm vlerësimi mbi marrëdhënien e bashkëpunimit ndërmjet tyre në raport me MD apo DNJF. Në vlerësim të përgjithshëm është e sugjerueshme ndërmarrja e hapave konkretë për ngritjen (aty ku është e mundur) dhe forcimin e urave të bashkëpunimit mes institucioneve në nivel vendor dhe atyre në nivel qendror, duke mbajtur në konsideratë garantimin e respektimit të të drejtave të publikut të gjerë. Aktualisht qytetarëve të Qarkut Kukës për të aksesuar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga ana e shtetit iu duhet të përshkujnë një distancë prej rreth 110 km, ose rreth 1 orë 30' për të aksesuar shërbime të ndihmës juridike falas pranë Qendrës për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike pranë Bashkisë Lezhë.

1.4.2.GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS DHE PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KUKËS

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës rezulton se gjatë periudhës Shtator 2020-Shtator 2021 janë depozituar 4 kërkesa të qytetarëve për të kërkuar ndihmë juridike dytësore (më konkretisht 2 kërkesa për procese të natyrës civile dhe 2 kërkesa për procese të natyrës penale). Nga ana e Gjykatës konstatohet se të gjitha këto kërkesa janë pranuar.

Sa i përket vlerësimit të njohurive që qytetarët disponojnë, përfaqësuesit e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës kanë bërë me dije se *“në vlerësimin tonë, në shumicën e rasteve qytetarët nuk disponojnë njohuritë e duhura për sa i përket të drejtës për akses në gjykatë, nëpërmjet ndihmës juridike të garantuar nga shteti”*.⁴³ Duke mbajtur në konsideratë këtë domosdoshmëri, përfaqësuesit e sistemit gjyqësor konstatohet se janë në të njëjtën linjë vlerësimi me përfaqësuesit e njësisë së qeverisjes vendore, duke e reflektuar si domosdoshmëri ndërmarrjen e masave konkrete për të ngritur një qendër për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës na ka informuar se pranë këtij institucioni në asnjë rast qytetarët nuk kanë depozituar kërkesë me shkrim për të kërkuar mbrojtje kryesisht, por kur është vlerësuar e nevojshme nga vetë përfaqësuesit e institucionit është caktuar mbrojtje kryesisht në respektim të nenit 309 K.Pr.Penale.⁴⁴ Pranë këtij institucioni është caktuar prokuror i posaçëm që trajton çështjet me subjekte të mitur, ndërkohë që koordinatorja e Prokurorisë në bashkëpunim me Bashkitë Kukës dhe Has, si dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës ka organizuar trajnime dhe takime lidhur me ndihmën juridike që duhet t'ju ofrohet individëve në nevojë, dhe procedurat që duhet të ndiqen për plotësimin e dokumentacionit për të përfituar nga kjo e drejtë. Pavarësisht se nga ana e Prokurorisë nuk janë dhënë informacione të detajuara mbi aktivitetet e realizuara, por në të përgjithshme aprovohet realizimi i tyre, prej tyre reflektohet si domosdoshmëri në të ardhmen marrja e masave konkrete për ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet Prokurorisë dhe MD për shtimin e kontakteve dhe realizimin e trajnimeve me fokus informimin dhe ndërgjegjësimin.

Nga të dhënat e reflektuara në analizat statistikore të DNJF-së, nuk ka qenë i mundur elaborimi i të dhënave të detajuara për shtetasit që kanë përfituar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga ana e shtetit, për shkak se ofruesit e shërbimeve nuk kanë reflektuar të dhëna të individualizuara mbi vendbanimin e palëve. Në mungesë të këtij kategorizimi mbetet e paqartë nëse qytetarët e Kukësit zgjedhin t'i drejtohen qendrave të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore pranë Bashkive Lezhë, Tiranë apo Shkodër.

Në mënyrë përgjithëse, nga situata e konstatuar në terren, KShH vëren se ngritja e një Qendre për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas është një hap i sugjeruar dhe i shumëpritur edhe nga vetë aktorët institucionalë në rang vendor.

⁴³ Shkresë nr. 650 prot., dt. 17.11.2021 “Kthim përgjigje” nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës

⁴⁴ Shkresë nr. 2062/1 prot., dt. 07.12.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës

KREU III

1. ANKETIME ME QYTETARË: “NË KËRKIM TË NDIHMËS JURIDIKE TË MUNGUAR NË QYTETIN KU BANOJ”

Gjatë sesioneve informuese të realizuara në 3 qytetet e vendit, përkatësisht në Librazhd, Kukës dhe Himarë, u anketuan rreth 200 qytetarë dhe iu ofrua ndihmë juridike parësore falas rreth 161 qytetarëve. Vlen të evidentohet se pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar janë anonimë, ndërkohë që i njëjti anonimati është ruajtur edhe në momentin e ofrimit të ndihmës juridike parësore. Tek qytetarët vijon të reflektohet mungesa e besimit tek institucionet publike, ndërkohë që organizatat e shoqërisë civile pavarësisht rolit të rëndësishëm që luajnë nëpërmjet iniciativave të kësaj natyre i shikojnë sitë pafuqishme përball sistemit gjyqësor vendas, duke qenë se pjesa më e madhe e problematikave ligjore të referuara prej tyre finalizohet në një zgjidhje përfundimtare vetëm nëpërmjet vendimmarrjes gjyqësore.

1.2. Qytetarët banues të bashkisë Librazhd

Gjatë aktiviteteve të ndërmarra në terren, ekipi i KShH-së ndërmori 4 sesione informuese dhe sensibilizuese si edhe 2 takime me përfaqësues të Drejtorisë Juridike pranë Bashkisë Librazhd dhe me Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Librazhd. Në këto takime morën pjesë dhe përfaqësues të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Paralelisht me sesionet e informimit dhe ato konsultuese me përfaqësuesit e institucioneve publike janë ndërmarrë dhe vizita në terren nën formatin *street laë*, gjatë të cilave ju është ofruar ndihmë ligjore parësore në formën e këshillimeve ligjore rreth 58 banorëve të qytetit të Librazhdit dhe të disa fshatrave përreth si Hotolisht dhe Orenjë.⁴⁵




Figura 6: Të dhëna të përpunuara nga anketimet e realizuara në terren nga stafi paraligjor i KShH-së


Gjatë anketimeve të realizuara në terren rreth 58.6% e qytetarëve i përkasin gjinisë mashkullore, ndërkohë rreth 41.4% janë femra.

Vlen të evidentohet se masa më e madhe e shtetasve që pranuan t'i nënshtrohen anketimet të realizuar i përkasin grupmoshës 36-50 vjeç rreth 40%), pasur nga grupmosha 26-35 vjeç (rreth 21.8%). Ky indikator në vlerësimin e KShH-së provon faktin se shtetasit që kanë zgjedhur të ndajnë me intervistuesit qëndrimin e tyre i

përkasin një kategorie të pjekurisë intelektuale dhe kulturës sociale.

⁴⁵ Nga të dhënat e përpunuara nga anketimet e realizuara në terren, duke qenë se pyetjet e adresuara nëpërmjet pyetësorit kanë qenë të një natyre jo të detyrueshme, konstatohet se jo të gjithë shtetasit e anketuar kanë zgjedhur t'i japin përgjigje të gjitha pyetjeve të adresuara.

Mosha
55 responses



Niveli arsimor
37 responses






Figura 7-8: Të dhëna të përpunuara nga anketimet e realizuara në terren nga stafi paraligjor i KShH-së

Gjithashtu, një tjetër element shqetësues në këndvështrimin e KShH-së është që pjesa më e madhe e shtetasve të anketuar (rreth 62.2%) na kanë informuar se kanë përfunduar studimet parauniversitare pranë Shkollës së Mesme, ndërkohë pjesa e mbetur prej 37.8% e qytetarëve disponojnë një diplomë universitare. Rreth 50.9% e shtetasve të anketuar reflektojnë një përvojë pune mbi 10 vjeçare, ndërkohë që një masë e reduktuar rreth 17% informojnë se zotërojnë eksperiencë në tregun e punës nga 0-1 vite.

A jeni në djehni të mundësisë së përfitimit të shërbimit juridik falas të garantuar nga shteti?
55 responses



Si do ta vlerësonit njohurinë tuaj juridike të përgjithshme?
53 responses




Figura 9-10: Të dhëna të përpunuara nga anketimet e realizuara në terren nga stafi paraligjor i KShH-së

Shumica e qytetarëve të anketuar, rreth 74.5% janë shprehur se nuk kanë djehni mbi ekzistencën e ligjit nr. 111/2017, dhe si rrjedhojë as mbi mundësinë e përfitimit të shërbimit juridik falas të garantuar nga shteti. Parë në analizë krahasimore ndërmjet të dhënave statistikore të reflektuara në vizualizimet e mësipërme, në këndvështrimin e ekspertëve të KShH-së është shqetësuese fakti që shtetas që disponojnë një diplomë universitare në një fushë konkrete dhe që reflektojnë eksperiencë të konsiderueshme në tregun e punës nuk disponojnë informacion bazik mbi mundësinë e përfitimit të shërbimit të ndihmës ligjore falas. Kjo e dhënë statistikore është proporcionale parë në raport me faktin se rreth 47.2% e qytetarëve janë shprehur se njohuritë juridike të përgjithshme i vlerësojnë si të dobëta. Masa më e vogël e qytetarëve prej 9.4%, e cila është e papërfillshme në raport me të dhënat statistikore, ka evidentuar se njohuritë e përgjithshme juridike që disponojnë janë shumë të mira.

Kjo mungesë e informimit ka bërë që masa më e madhe prej 83% e qytetarëve të anketuar në Bashkinë Librazhd të mos i drejtohen asnjëherë institucioneve shtetërore për të kërkuar ndihmë juridike, ndërkohë që 17% e tyre kanë zgjedhur të trokasin në dyert e institucioneve për të kërkuar zgjidhje mbi problemin e tyre ligjor.

Nëse po, institucionet a ju kanë orientuar lidhur me procedurën që duhet të ndiqni?
13 responses




Figura 11: Të dhëna të përpunuara nga përgjigjet e dhëna nga 13 qytetarë

zgjedhur që të mos i drejtohen institucioneve për të kërkuar orientim ligjor mbi procedurat që duhet të ndiqen për të përfituar shërbim ligjor.

Nëse jo, nuk jeni drejtuar sepse:
43 responses





Figura 12: Të dhëna të përpunuara nga përgjigjet e dhëna nga 43 qytetarë

janë ndjerë të diskriminuar ndërsa 2 shtetasve (ose rreth 4.7% e totalit) ju është mohuar akses/shërbimi përkatës.

Një masë e madhe e shtetasve të anketuar, rreth 48 qytetarë kanë zgjedhur që të japin përgjigje mbi pyetjen e adresuar drejt tyre për mundësinë e përfitimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.


A keni përfituar ndonjëherë ndihmë juridike falas të garantuar nga shteti?
48 responses



Rreth 95.8% e shtetasve nuk kanë përfituar asnjëherë shërbime të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, ndërkohë që rreth 4.2% e tyre (ose 2 shtetas) ju janë drejtuar institucioneve përgjegjëse për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga ana e shtetit, në formën e ndihmës juridike dytësore. Ndër shtetasit jopërfitues, KShH ka mundur që të grumbullojë informacion vetëm nga 6 prej tyre, të cilët më së shumti kanë evidentuar mungesë të besimit për përfitimin e kësaj të drejte, mungesën e dijenisë mbi ekzistencën e kësaj të drejte, ose mundësinë financiare të familjarëve për të kërkuar mbrojtjen e interesave ligjore nga ana e një avokati të zgjedhur. Qytetarët të cilët kanë përfituar shërbime të ndihmës juridike falas kanë shprehur vlerësimin e tyre mbi shërbimin e ofruar nga ana e mbrojtësve ligjorë të caktuar kryesisht.

Figura 13: Të dhëna të përpunuara nga KShH


Mendoni se mund të kishit marrë një këshillim ligjor më të mirë/përfaqësues ligjor më të mirë nëse do të kishit paguar për këtë shërbim, pa ju drejtuar ndihmës juridike shtetërore?
11 responses



11 qytetarë pjesë e grupit të shtetasve të anketuar, kanë ndarë me ekipin e KShH-së një qëndrim/opinion të njëjtë lidhur me cilësinë e ndihmës juridike që mund të përfitonin, nëse për këtë shërbim do të kishin paguar një mbrojtës të zgjedhur kryesisht nga ana e familjarëve. 4 prej qytetarëve janë shprehur se nuk janë aspak dakord që cilësia e shërbimit është e ndërlidhur me koston financiare, ndërkohë që 4 qytetarë të tjerë janë shprehur se e vlerësojnë në marzhin 7 cilësinë e shërbimit ligjor të ofruar, duke reflektuar këndvështrimin e qytetarëve të cilët mendojnë se në rast se do të akordohej një kosto konkrete mbrojtja ligjore do të ishte më efikase.

Figura 14: Të dhëna të përpunuara nga KShH

Tashmë që u informuat për mundësinë e këtij shërbimi juridik falas, a do ta konsideronit të përfitoni prej këtij shërbiminë rast nevojë në të ardhmen?
49 responses



KShH vlerëson se nëpërmjet këtyre anketimeve, hapa pozitivë janë ndërmarrë në funksion të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve për të përfituar shërbime të ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit. Nga 49 shtetas të cilët zgjodhën që t'i përgjigjen pyetjes së adresuar mbi konsiderimin e mundësisë në të

Figura 15: Të ardhura të përpunuara nga KShH

ardhmen për të përfituar ndihmë juridike falas, konstatohet se rreth 75.5% e qytetarëve do të

zgjidhnin që t'i drejtoheshin ofruesve të ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit, ndërkohë që 16.3% e qytetarëve kanë përzgjedhur opsionin “ndoshta” kurse 8.2% e shtetasve nuk do të zgjidhnin që të përfitonin ndihmë juridike nga ana e shtetit. Qytetarët të cilët nuk kanë përzgjedhur t'i drejtohen as në të ardhmen kanë adresuar si shkaqe ndikuese: mungesën e besimit pranë institucioneve shtetërore; mundësinë e përzgjedhjes së një avokati privat ose mbajtjen në konsideratë të mundësisë së përfitimit nga kjo e drejtë në momentin kur qytetarit t'i nevojitet.

1.3. Qytetarët banues të bashkisë Himarë

Mosha
64 responses




Figura 16: Të dhëna të përpunuara nga KShH, bazuar në përgjigjet e 64 qytetarëve

Në qytetin e Himarës, anketimet përzgjedhën t'i nënshtroheshin rreth 64 qytetarë, 50% e të cilëve të gjinisë mashkullore dhe 50% të gjinisë femërore. Sa i përket grupmoshës së shtetasve që zgjodhën t'ju përgjigjen pyetjeve në pjesën më të madhe të anketimit, rezulton se 50% e shtetasve janë 26-35 vjeç, ndërkohë që të rinjtë e grupmoshës 18-25 vjeç përbëjnë rreth 10.9%. Të rriturit pjesë e grupmoshës 36-50 vjeç përbëjnë rreth 21.9%, ndërkohë që vetëm 10.9% e të anketuarve i përkasin moshës mbi 51 vjeç.




Figura 17: Të dhënë të përpunuara nga KShH

Rreth 53.8% e qytetarëve rezultojnë se kanë një përvojë profesionale në tregun e punës për një periudhë kohore 1-5 vite, ndërkohë që 34.6% e të anketuarve përzgjedhën opsionin e përvojës mbi 10 vjeçare. Nëpërmjet këtyre të dhënave evidentohet se shtetasit që kanë përzgjedhur t'i nënshtrohen këtij anketimi të individualizuar janë të rinj, të cilët janë integruar në tregun e punës.




Figura 18: Të dhëna të përpunuara nga 52 përgjigjet e adresuara nga qytetarët

60 qytetarët e anketuar ose rreth 93.3% referuan se nuk janë në dijeni të mundësisë së përfitimit të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Ndërkohë që vetëm 4 shtetas ose rreth 6.7% kanë dijeni mbi ekzistencën e kësaj të drejtë. Në përgjithësi pjesa më e madhe e shtetasve të anketuar kanë evidentuar se rreth 85.2% e vlerësojnë si të dobët njohurinë e tyre juridike të




Figura 19: Të dhëna të përpunuara nga KShH

përgjithshme. Duke e vlerësuar si të drejtë korrelacionin ndërmjet këtyre dy të dhënave, KShH konstaton se vetëm 4 shtetas ose rreth 6.6% e kanë rankuar si 'të mirë' nivelin e njohurive të tyre të përgjithshme.

Si rrjedhojë e kësaj mungese informacioni mbi të drejtën





Figura 20-21: Të dhëna të përpunuara nga KShH

për të aksesuar shërbime ligjore falas, por edhe nivelit jo të kënaqshëm të njohurive të përgjithshme, rreth 95.6% e qytetarëve rezultojnë se nuk i janë drejtuar asnjëherë asnjë institucioni shtetëror për të depozituar një ankesë ose për të kërkuar ndihmë juridike. Duke qenë se vetëm 2 qytetarë kanë zgjedhur që t'i besojnë zgjidhjen e çështjes së tyre ligjore institucioneve përgjegjëse, ata vlerësojnë se nga ana e autoriteteve publike janë orientuar në mënyrën e duhur. Duke qenë se 13 qytetarë kanë zgjedhur që t'i përgjigjen pyetjes mbi vlerësimin e orientimit të ofruar nga institucioni përgjegjës, KShH vëren se 84.6% e tyre të cilët kanë përzgjedhur se institucionet nuk i kanë orientuar në mënyrën e duhur, reflektojnë mungesë të adresimit korrekt të kërkesë/ankesës pranë institucioneve publike, pasi njëkohësisht ata kanë përzgjedhur opsionin në pyetjen e mëparshme se asnjëherë nuk i janë drejtuar institucioneve përgjegjëse për të kërkuar ndihmë juridike. Pra qytetarët reflektojnë këndvështrimin se në rast të mos ofrimit të një zgjidhjeje konkrete rreth problemit të tyre nga ana e institucioneve publike, merret e mirëqenë se ata nuk i janë drejtuar asnjëherë institucionit, duke mos e vlerësuar në formën e duhur



ndihmën juridike parësore që mund t'i jetë ofruar. Një këndvështrim i tillë reflekton një mungesë të informimit dhe kulturës mbi ndihmën juridike të garantuar nga ana e shtetit.


Nëse jo, nuk jeni drejtuar sepse:
58 responses



Rreth 69% e 58 qytetarëve të anketuar referojnë se ato nuk i janë drejtuar institucioneve publike për shkak se nuk kanë pasur informacion bazik mbi mundësinë e ofrimit të këtij shërbimit, ndërkohë që 31% e qytetarëve nuk janë ndeshur me problematika ligjore, për trajtimin e të cilave institucione konkrete janë përgjegjëse.

Figura 22: Të dhëna të përpunuara nga KShH

A keni përfituar ndonjëherë ndihmë juridike falas të garantuar nga shteti?
57 responses




Nëse po, a keni kërkuar konsullencë juridike apo avokat?
2 responses



Figura 22-23: Të dhëna të përpunuara nga KShH

Rreth 98.2% e qytetarëve informojnë se nuk kanë përfituar asnjëherë ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Kjo mungesë e aksesit për përfitimin e shërbimeve të ndihmës juridike është e ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me kulturën juridike të munguar të qytetarëve, dhe mungesën e sensibilizimit efektiv të tyre mbi garancitë e procedurat e parashikuara nga ligji nr. 111/2017.

Si do ta vlerësonit efikasitetin e konsullencës që ju është dhënë/avokatit që ju është caktuar?
3 responses



Mendonit se mund të kishit marrë një këshillim ligjor më të mirë/përfaqësim ligjor më të mirë nëse do të kishit paguar për këtë shërbim, pa ju drejtuar ndihmës juridike shtetërore?
2 responses




Figura 24-25: Të dhëna të përpunuara nga KShH

Cilësia e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas është vlerësuar si e mirë nga ana e 2 qytetarëve, ndërkohë që qytetarët e anketuar vlerësojnë se në rast se do të paguanin për këtë shërbim nuk do të kishin premisa më të shtuara për të marrë një këshillim ligjor ose përfaqësim ligjor më të mirë.

Tashmë që u informuat për mundësinë e këtij shërbimi juridik falas, a do ta konsideronit të përfitoni prej këtij shërbiminë rast nevojë në të ardhmen?
63 responses




Figura 26: Të dhëna të përpunuara nga përgjigjet e dhëna nga 63 qytetarë

Pas anketimit të realizuar, qytetarët e patën të mundur që të bashkëbisedojnë dhe të ndajnë opinione me ekipin e paraligjorëve. Rreth 66.7% e tyre u shfaqën të bindur se pas informacionit të detajuar me të cilin u njohën gjatë takimeve në terren, në të ardhmen nëse do të përballen me problematika të karakterit ligjor do t'i drejtohen ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike falas për të përfituar nga e drejta e aksesit në drejtësi. Ndërkohë rreth 25.4% e qytetarëve u shfaqën jo të vendosur, duke

e ndërlidhur mundësinë e adresimit të kërkesës për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga ana e shtetit në të ardhmen, në rast se do t'ju nevojitet të kërkojnë ndihmë për zgjidhjen e çështjeve ligjore.

1.4. Qytetarët banues të bashkisë Kukës

Gjinia
63 responses




Figura 27: Të dhëna të përpunuara nga KShH

63 qytetarët e anketuar gjatë vizitave të realizuara në qytetin e Kukësit shfaqin një këndvështrim të njëjtë me shtetasit e tjerë të cilët janë të lokalizuar në Bashkitë Librazhd dhe Himarë, por për të cilët shqetësimi mbetet i njëjtë, ai për aksesin në drejtësi në sajë të ndihmës ligjore të garantuar nga ana e shtetit. Në dallim nga qytetet e tjera në Bashkinë e Kukësit u mor takim me rreth 60.3% qytetare të gjinisë femërore, ndërkohë që vetëm 39.7% e tyre ishin meshkuj.

Pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar i përkasin grupmoshës “të rinj”, konkretisht rreth 36.7% e tyre janë të moshës 26-35 vjeç, ndërkohë që grupmosha 18-25 vjeç është shfaqur jo shumë e interesuar në këtë qytet për të kontribuar nëpërmjet plotësimit të anketimit. Vlerësohet se ky indikator është i mirëkuptueshëm në raport me problematikat ligjore të cilat më së shumti adresohen dhe ndiqen pranë institucioneve publike nga ana e një tjetër kategorie grupmoshe.

Mosha
60 responses




Figura 28: Të dhëna të përpunuara nga 60 përgjigje të adresuara nga qytetarët

Niveli arsimor
38 responses




Figura 29: Të dhëna të përpunuara nga KShH

Ashtu si në qytetet e tjera në të cilat kjo iniciativë u zbatua, edhe në qytetin e Kukësit konstatojmë se pjesa më e madhe e të anketuarve, rreth 73.7% kanë përfunduar studimet parauniversitare Shkollën e Mesme, ndërkohë që vetëm 21.1% e qytetarëve disponojnë një diplomë universitare. Duke analizuar të ndërlidhura të dhënat statistikore vërejmë se një pjesë e vogël e popullatës së anketuar zgjedhin që të ofrojnë informacion mbi nivelin e tyre arsimor. Pjesa më e madhe e tyre,

rreth 36.6% janë shprehur se kanë mbi 10 vite përvojë profesionale, ndërkohë që në masë më të reduktuar shfaqen qytetarët me një përvojë pune rreth 0-1 vit.

Përvoja e punës
41 responses




Figura 30: Të dhëna të përpunuara nga përgjigjet e 41 qytetarëve

Të dhënat e reflektuara mbi përvojën e punës reflektojnë një popullatë të anketuar e cila disponon një kulturë të caktuar sociale dhe akademike, të cilët ndërveprojnë për një periudhë të gjatë kohore me të tretët.

Pavarësisht këtij ndërveprimi, ekspertët kanë konstatuar se rreth 83.3% e të anketuarve janë shprehur se nuk janë në dijeni të mundësisë së përfitimit të ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit, ndërkohë që një pjesë e vogël rreth 16.7% (ose 10 qytetarë) dispononin disa njohuri bazike

mbi ekzistencën e kësaj të drejte, por shfaqen konfuzë mbi procedurat që duhet të ndiqen dhe institucioneve të cilave duhet t'ju drejtohen për të përfituar nga ky shërbim. Siç dhe është konstatuar gjatë takimeve të përbashkëta në terren me përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore, përfaqësuesit e zyrës lokale të Avokatit të Popullit vlerësohen si një institucion proaktiv dhe aktor i rëndësishëm në favor të sensibilizimit

dhe informimit të qytetarëve mbi të drejtat e tyre themelore dhe të drejtën për të aksesuar në drejtësi nëpërmjet ndihmës ligjore falas.

Si do ta vlerësonit njohurinë tuaj juridike të përgjithshme?
57 responses




Figura 31: Të dhëna të përpunuara nga KShH

A jeni drejtuar ndonjëherë ndonjë institucioni shtetëror (p.sh.Bashkisë/Av. Popullit) për të bërë ankesë/për të kërkuar ndihmë juridike?
45 responses




Figura 32: Të dhëna të përpunuara nga përgjigjet e 45 qytetarëve

pasiguria që problematika e tyre ligjore mund të zgjidhet në rrugë administrative. Edhe gjatë momenteve të ofrimit të këshillimeve ligjore nga ana e paraligjorëve të KShH-së në terren është konstatuar se në momentin e orientimit të qytetarëve për të ndjekur rrugën gjyqësore të zgjidhjes së çështjes së tyre si një formë e duhur për rivendosjen në vend të së drejtës së cënuar, kanë reflektuar hezitim dhe heqje dorë për shkak të afateve të zgjatura në kohë që i nevojiten Gjykatës për të shqyrtuar çështjen, nivelin e korrupsionit dhe ndikimeve të paligjshme nga ana e palës kundërshtarë, si dhe pamundësitë ekonomike për të ndjekur të gjitha rrugët e sistemit gjyqësor të bindur se në shkallët e ulëta të gjykimit çështja mund të jetë e humbur.

Nëse po, institucionet a ju kanë orientuar lidhur me procedurën që duhet të ndiqni?
13 responses




Figura 33: Të dhëna të përpunuara nga KShH

tyre. Në momentin e orientimit të tyre pranë institucioneve kompetente apo këshillimin për ndjekjen e procedurës gjyqësore, qytetarët tentojnë që ta quajnë orientimin të pavend.


Nisur nga opsionet e përzgjedhura nga vetë qytetarët, ekspertët konstatojnë se qytetarët shfaqen të pasigurtë dhe konfuzë lidhur me faktin se në cilin moment duhet të konsiderohet nga ana e institucioneve ofrimi i ndihmës ligjore të garantuar nga shteti. Nga 57 qytetarë që kanë zgjedhur t'i përgjigjen kësaj pyetje është vlerësuar se njohuritë e tyre juridike të përgjithshme janë të dobëta në masën rreth 68.4%, ndërkohë që vetëm 5.3% ose 3 qytetarë dispononin njohuri shumë të mira juridike, për shkak të studimeve akademike në fushën e drejtësisë.

Ndikuar nga mungesa e njohurive të përgjithshme, rreth 84.4% e qytetarëve nuk i janë drejtuar asnjëherë ndonjë institucioni shtetëror për të depozituar një ankesë apo kërkesë për të përfituar shërbime të ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit. Vetëm 15.7% ose 7 qytetarë kanë zgjedhur që tja besojnë zgjidhjen e problematikës së tyre institucioneve shtetërore. Gjatë bashkëbisedimeve me qytetarët krahas mungesës së informacionit mbi ekzistencën e kësaj të drejte dhe rolin e kompetencat e institucioneve publike në nivel vendor, reflektohet në një masë të gjerë

Kjo formë perceptimi e qytetarëve, ka bërë që 10 qytetarë nga 13 që i janë adresuar institucioneve publike për të kërkuar zgjidhje për çështjen e tyre ta vlerësojnë orientimin e institucioneve në masën 76.9% si të munguar ose jo të duhur. Siç dhe më lart evidentuam, në momentin e adresimit të kërkesës/ankesës së tyre pranë një institucioni në nivel administrativ, tek qytetarët krijohet pritshmëria se zgjidhja mund të ofrohet nga ana e këtij institucioni pa qenë nevoja që të ndjekin rrugë të tjera ligjore për të kërkuar përmbushjen e së drejtës së

Pjesa tjetër e qytetarëve, rreth 49 qytetarë kanë referuar arsyet/opinionin e tyre përse kanë zgjedhur që të mos i drejtohen në asnjë rast institucioneve publike për të kërkuar ndihmë ligjore. Rreth 51% e qytetarëve janë shprehur se nuk kanë pasur nevojë që t'i drejtohen, ndërkohë që rreth 49% e tyre nuk kanë pasur informacion për mundësinë e ofrimit të shërbimit të garantimit të ndihmës juridike falas.

Nëse jo, nuk jeni drejtuar sepse:
49 responses



A keni përfituar ndonjëherë ndihmë juridike falas të garantuar nga shteti?
52 responses




Figura 35: Të dhëna të përpunuara nga 52 përgjigjet e qytetarëve

Figura 34: Të dhëna të përpunuara nga KSHH

Rreth 92.5% nga 52 qytetarë të anketuar nuk kanë përfituar ndonjëherë ndihmë juridike të garantuar nga ana e shtetit, ndërkohë që rreth 7.7% kanë përfituar shërbime konkrete në formën e ndihmës juridike parësore ose dytësore.

shprehen se kanë përfituar konsulencë juridike, ndërkohë që 33.3% kanë kërkuar asistencën e përfaqësimit të interesave të tyre ligjore nëpërmjet një avokati. Ka pasur raste ndër të anketuarit, të cilët janë shprehur se kanë përfituar shërbime ligjore të të dyja natyrave për shkak të çështjes ligjore në ngarkim të tyre.

Duke qenë të paqartë mbi kategorizimin e natyrës së ndihmës juridike të përfituar, rreth 66.7% e qytetarëve

Si do ta vlerësonit efikasitetin e konsulencës që ju është dhënë/avokatit që ju është caktuar?
5 responses




Figura 36: Të dhëna të përpunuara nga KSHH

Në përgjithësi qytetarët e kanë vlerësuar si 'të mirë' efikasitetin e konsulencës që ju është ofruar gjatë procedurës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Ndërkohë vetëm në 1 rast ose rreth 20% qytetari e vlerësoi këtë ndihmë juridike të ofruar si 'të dobët'. Gjatë bashkëbisedimit me qytetarin mbi çështjen konkrete të trajtuar, për të cilën orientime konkrete ishin dhënë nga ana e përfaqësuesit të një prej institucioneve në nivel vendor, i cili nuk është ofruar i shërbimeve të ndihmës juridike parësore në kuptim të

ligjit nr. 111/2017, konstatoam se orientimi i ofruar ishte bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, por një zgjidhje e tillë nuk ishte pëlqyer nga ana e qytetarit, duke nxitur mosbesim për t'ju drejtuar sërish institucioneve përgjegjëse e për të vijuar procedurën në ndjekjen e ankesës së tij.

Mendonit se mund të kishit marrë një këshillim ligjor më të mirë/përfaqësim ligjor më të mirë nëse do të kishit paguar për këtë shërbim, pa ju drejtuar ndihmës juridike shtetërore?
15 responses




Figura 37: Të dhëna të përpunuara nga përgjigjet e 15 qytetarëve

Ndërkohë që masa më e madhe e qytetarëve të anketuar shfaqën hezitim për të përfituar shërbime të ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit, me pretendimin se mbrojtësit ligjor të caktuar kryesisht nga institucionet nuk mbrojnë në mënyrë të plotë interesat e qytetarëve, konstatoam dhe një grup të vogël prej 15 qytetarësh të cilët pranuan që të ndanin me ne opinionin e tyre mbi cilësinë e ndihmës juridike të ofruar falas në mungesë të një kostoje financiare të paguar nga ana e qytetarit, në raport me rastet kur avokati zgjidhet dhe paguhet privatisht nga ana e palës. Rreth 53.3% ose 8 qytetarë

mendonin se po të kishin paguar vetë një kosto konkrete vëmendja e ofruesit të shërbimit ligjor dhe cilësia e këtij shërbimi do të ishte më e kënaqshme, ndërkohë që vetëm 3 qytetarë ose rreth 20% shprehen se cilësia e shërbimit ligjor të ofruar do të ishte e njëjlojtë dhe nuk varet domosdoshmërisht me koston financiare të ofruar nga qytetari. Sipas këndvështrimit të ekspertëve, gjatë bashkëbisedimeve dhe opinionëve që këta qytetarë në

pakicë kanë reflektuar, cilësia e shërbimeve ligjore lidhet pazgjidhshmërisht me përgjegjësinë individuale të ofruesit të shërbimit për të garantuar respektimin e të drejtës së shtetasit për të përfituar akses efikas dhe pa vonesa në drejtësi.

Tashmë që u informuat për mundësinë e këtij shërbimi juridik falas, a do ta konsideronit të përfitoni prej këtij shërbiminë rast nevojë në të ardhmen?
53 responses




Figura 38: Të dhëna të përpunuara nga KShH

juridike të garantuar nga ana e shtetit. Ndërkohë 8 qytetarë ose rreth 15.1% për shkak të eksperiencave të mëparshme me institucionet publike dhe sistemin gjyqësor, nuk do të zgjedhin që në të ardhmen të përfitojnë shërbim juridik falas, ndërkohë që parandalimin e cënimit ose rivendosjen në vend të së drejtës së cënuar do ia besojnë një avokati privat të paguar prej tyre ose familjarët e tyre.

Ashtu si në qytetet e tjera të vendit, gjatë plotësimit të këtyre pyetësorëve, ekipi i paraligjorëve ka shkëmbyer opinione dhe këndvështrime me qytetarët, si dhe ka informuar ata në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi ekzistencën e kësaj të drejte dhe lokalizimin më të afërt të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit. Nëse në të ardhmen do të përballen me një problem ligjor, rreth 62.3% e qytetarëve do ta konsiderojnë mundësinë që t'i adresohen ofruesve përgjegjës për të përfituar shërbime të ndihmës

GJETJET KYÇE DHE REKOMANDIME

Gjetjet kyçe të evidentuara gjatë këtij procesi monitorimi të shtrirë në 3 qytete të vendit konsistojnë në:

I. ASPEKTE JURIDIKE:

- Konstatohet paralelizëm dhe përplasje mes dy procedurave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 111/2017 dhe Kodi i Procedurës Penale, pasi ligji parashikon plotësimin e formatit të formularit të kërkesës për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti, si dhe formularin e vetë-deklarimit në rastet e mungesës së të ardhurave financiare për të përballuar shpenzimet për ndihmë juridike dytësore. Ndërkohë për kategorinë e shtetasve të ndodhur në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, është e detyrueshme nga ana e organit procedues marrja e masave konkrete, që edhe në mungesë të depozitimit të këtyre formateve të kërkesave të plotësuara, të caktojnë në dispozicion të qytetarit mbrojtës ligjor të caktuar kryesisht. Por në të dyja rastet, organi procedues më konkretisht Prokurori ose Gjykata shqyrton rastin dhe i siguron një mbrojtës kryesisht të caktuar nga shteti të pandehurit.
- Në proceset penale, edhe në kushtet kur i pandehuri nuk përfshihet në kategorinë e subjekteve të cilët mund të përfitojnë mbrojtje të detyrueshme sipas nenit 49 të K.Pr.Penale, por nuk disponon mjete të mjaftueshme financiare ligjvënësi ka parashikuar detyrimin mbi organin procedues për të caktuar mbrojtës nga lista e vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike dytësore të garantuar nga shteti. Duke u bazuar në dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 111/2017, procedurat e kërkuara pasqyrohen të shtuara, ndërkohë që shtetasi duhet t'i bashkëlidhë kërkesës për ndihmë juridike dytësore edhe dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar shërbime të kësaj natyre dhe për të vërtetuar gjendjen e paaftësisë së tij paguese ose përfshirjen në kategoritë e ve@anta. Ky dokumentacion i kalon për verifikim prokurorit të çështjes duke i ngarkuar këtij organi përgjegjësinë e caktimit të një mbrojtësi ligjor falas. Kjo procedurë kërkon një kohë të dedikuar dhe shoqërohet me burokraci sa i përket caktimit të një mbrojtësi ligjor, ndërkohë që procesi i caktimit të një avokati kryesisht, sidomos nëse shprehet si kërkesë përpara gjykatës është procedurë më e thjeshtuar dhe e shpejtë. Në të dyja rastet, buxheti i dedikuar për avokatin mbulohet nga buxheti i shtetit.
- Nevoja për plotësimin e formularëve të vetëdeklarimit mbi paaftësinë financiare të individit shton barrën e provës për individin, i cili duhet të dorëzojë dokumentacion shtesë provues mbi gjendjen e tij/saj të vështirë ekonomike. Kjo procedurë shton gjithashtu barrë për prokurorin apo gjykatën për të kryer verifikimin përfundimtar të gjendjes ekonomike të vështirë të personit. Vonesat mund të shkaktohen edhe si pasojë e pamundësisë apo mundësisë së kufizuar që kjo kategori e shtetasve ka në aksesin në platforma elektronike, siç është E-Albania, nëpërmjet të cilës mund të aksesohen akte të ndryshme provuese me vulë elektronike. Vështirësia në provimin e situatës së vështirë ekonomike mund të lëri hapërsirë për mohimin e të drejtës për të përfituar ndihmë juridike falas dhe si rrjedhojë krijohen premisa për mohim të aksesit në drejtësi të personave që realisht mund të jenë në kushtet e parashikuara nga ligji për ta përfituar këtë të drejtë.
- Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike falas në Bashkitë më të afërta në raport me ato objekt monitorimi rezultojnë që janë ngritur dhe të plotësuara me staf sipas organikës së miratuar, me shumë vonesë. Më konkretisht Qendra funksionale në Vlorë është plotësuar në Shkurt 2021, ndërkohë Qendra e Elbasanit rezulton e ngritur në Janar 2020.
- Largësia e evidentuar midis Qendrave të Shërbimit Juridik Falas të vendosura pranë gjykatave të Shkallës së Parë Elbasan, Lezhë dhe Vlorë dhe qyteteve si Librazhdi, Kukësi dhe Himara, ndikon në garantimin e të drejtës për akses në drejtësi pa vonesa dhe adekuat, si një nga të drejtat bazike të përfshira në suazën e nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

II. ASPEKTE SOCIALE:

- Gjendja e vështirë financiare e dëshmuar nga banorët e qyteteve objekt monitorimi ndikon negativisht në aftësinë e tyre për të patur informacion bazik mbi të drejtën për ndihmë juridike të garantuar nga shteti, pasi aksesit në mjete teknologjike është i ulët ose inekzistent, fakt ky që e bën gati të pamundur përfitimin e informacionit nëpërmjet faqeve zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë apo Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Sipas anketimeve, mungesa e përgjithshme e informacionit ligjor që i karakterizon ndikon në adresimin e qytetarëve drejt studiove ligjore me pagesë, përzgjedhje e cila e rëndon gjendjen e tyre socio-ekonomike dhe jo domosdoshmërisht mund të përkthehet në një cilësi më të mirë të shërbimit ligjor të ofruar.
- Qytetarët banues në Himarë, Kukës dhe Librazhd janë të detyruar që të ndërmarrin kosto financiare, kosto kohore por edhe të udhëtojnë në distanca relativisht të konsiderueshme për të përfituar shërbime të ndihmës juridike parësore. Këto faktorë të ndërlidhur me elementë ndikues si niveli arsimor dhe kultura sociale ndikojnë në hezitimin e qytetarëve, krijimin e një fryme në masë mbi mungesën e besimit të tyre në kompetencat institucionale etj.
- Ekzistenca e mëhershme e zyrave lokale të Avokatit të Popullit ndikon në konceptin e banorëve si mënyra e parë ose e vetme e aksesit në të drejtën për mbrojtje të të drejtave të tyre apo si institucioni më i përshtatshëm për t'u drejtuar për gjetjen e zgjidhjeve ligjore për ankesa të ndryshme, pa marrë parasysh që këto zyra lokale nuk janë ofruar të drejtpërdrejtë të shërbimeve të ndihmës juridike parësore në kuptim të ligjit nr. 111/2017, por i ofrojnë këto shërbime në kuadër të misionit të tyre kushtetues.

Rekomandime

Pas gjetjeve të reflektuara në terren, vlerësohet se rekomandimet e mëposhtme do të ndihmojnë sadopak në përmirësimin e funksionalitetit më proaktiv të mekanizmit të ofrimit të ndihmës juridike falas pranë Bashkive objekt monitorimi:

1. Rekomandohet ndërmarrja e fushatave sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese në nivel Kombëtar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, nëpërmjet takimit periodik me qytetarët, me institucionet kompetente në nivel vendor, dhe shpërndarjes së materialeve në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për qytetarët. Marrë shkas nga situata e konstatuar në terren, KShH sugjeron mbajtjen në konsideratë të realizimit të aktiviteteve informuese kryesisht në qytetet në territorin juridiksional të të cilave nuk operojnë ofruar të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit.
2. Rekomandohet forcimi i marrëdhënieve ndër-institucionale të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në nivel qendror, atyre në nivel vendor, sistemit të drejtësisë penale dhe qytetarëve, me synim informimin e qytetarëve mbi ekzistencën e së drejtës për të aksesuar në drejtësi nëpërmjet ndihmës juridike falas, por edhe rikthimin e besimit të tyre tek roli dhe kompetencat e autoriteteve publike.
3. Rekomandohet rritja e kapaciteteve të stafit të zyrave juridike pranë Njësisë të Qeverisjes Vendore nëpërmjet trajnimeve apo përfshirjes në sesione informuese të realizuara nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, rreth procedurave ligjore, kritereve dhe kushteve që duhet të përmbushen për garantimin e respektimit të ligjit nr. 111/2017. Gjithashtu, sugjerohet që pranë zyrave të pritjes së qytetarëve pranë Bashkive të angazhohet një person i dedikuar me njohuri ligjore, për orientimin e banorëve në rast nevojë apo paqartësie mbi procedurën që duhet të ndiqet dhe institucionet pranë të cilave depozitohet kërkesa për përfitimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.
4. Sugjerohet përfshirja e të rinjve në aktivitete ndërgjegjësuese me fokus edukimin ligjor mbi ndihmën juridike të garantuar nga ana e shtetit, si dhe marrja e masave konkrete për afishimin e materialeve promovuese të hartuara nga ana DNJF-së në ambientet e institucioneve në nivel vendor, pranë të cilave aksesit i qytetarëve është i shtuar.
5. Rekomandohet marrja e masave konkrete dhe të menjëhershme nga ana e MD dhe DNJF-së për të ngritur Qendrën e planifikuar në terma afatshkurtër pranë Bashkisë Kukës, ndërkohë që në të

ardhmen mund të konsiderohet ngritja e këtyre qendrave ose rivitalizimi i operatorëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore pranë Bashkive Himarë dhe Librazhd.

ANEKS 1

PYETËSORI I - PËR QYTETARËT

Ky pyetësor është krejtësisht anonim dhe do të përdoret vetëm për qëllime studimore në kuadrin e projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" që zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe financim të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA). Faleminderit!

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Gjinia:

- a. Mashkull
- b. Femër

2. Mosha

- a. 18–25 vjeç
- b. 26–35 vjeç
- c. 36–50 vjeç
- d. Mbi 51

3. Niveli arsimor

- a. I mesëm
- b. Diplomë universitare
- c. Pasuniversitare
- d. Doktoraturë

4. Përvoja e punës:

- a. 0 - 1 vit
- b. 1- 5 vjet
- c. 5-10 vjet
- d. Mbi 10 vjet

PYETJET PËR VLERËSIMIN E SHËRBIMIT JURIDIK FALAS

- 1. A jeni në dijeni të mundësisë së përfitimit të shërbimit juridik falas të garantuar nga shteti?**

- a. Po
- b. Jo

Arsye:

2. Si do ta vlerësonit njohurinë tuaj juridike të përgjithshme?

- a. Të shkëlqyer
- b. Shumë të mirë
- c. Të mirë
- d. Mesatare
- e. Të dobët

3. A jeni drejtuar ndonjëherë ndonjë institucioni shtetëror (p.sh.Bashkisë/Av. Popullit) për të bërë ankesë/për të kërkuar ndihmë juridike?

- a. Po
- b. Jo

4. Nëse po, institucionet a ju kanë orientuar lidhur me procedurën që duhet të ndiqni?

- a. Po**
- b. Jo**

5. Nëse jo, nuk jeni drejtuar sepse:

- a. Nuk keni patur nevojë për t'iu drejtuar;
- b. Nuk keni pasur informacion për mundësinë e ketij shërbimi;

- c. Nuk jeni ndjerë të mirëpritur;
- d. Nuk ju kanë trajtuar mirë;
- e. Jeni ndjerë të diskriminuar;
- f. Jua kanë mohuar aksesin/shërbimin.

6. A keni përfituar ndonjëherë ndihmë juridike falas të garantuar nga shteti?

- c. Po**
- d. Jo**

Arsye:

7. Nëse po, a keni kërkuar konsulencë juridike apo avokat?

- a. Konsulencë juridike
- b. Avokat

8. Si do ta vlerësonit efikasitetin e konsulencës që ju është dhënë/avokatit që ju është caktuar?

- a. Të shkëlqyer
- b. Shumë të mirë
- c. Të mirë

- d. Mesatar
- e. Të dobët

9. Mendoni se mund të kishit marrë një këshillim ligjor më të mirë/përfaqësim ligjor më të mirë nëse do të kishit paguar për këtë shërbim, pa ju drejtuar ndihmës juridike shtetërore?

Aspak dakord 1 2 3 4 5 6 7 Shumë dakord

Arsye:

10. Tashmë që u informuat për mundësinë e këtij shërbimi juridik falas, a do ta konsideronit të përfitoni prej këtij shërbiminë rast nevojë në të ardhmen?

- a. Po
- b. Jo
- c. Ndoshta

Komente shtesë:

ANEKS 2

PYETËSORI II - PËR INSTITUCIONET

Ky pyetësor do të përdoret vetëm për qëllime monitoruese dhe studimore në kuadrin e projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" që zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe financim të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA). Faleminderit!

INSTITUCIONI:

1. Sa jeni në dijeni të Ligjit Nr. 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti"?

- a. Shumë
- b. Pak
- c. Aspak
- d. Jam personi përgjegjës i caktuar për garantimin e zbatimit të këtij ligji.

2. A është krijuar Zyra vendore e ndihmës juridike falas sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti" në institucionin tuaj?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk kam dijeni.

Arsye:

3. Nëse jo, cila është alternativa e ofruar prej institucionit tuaj në dhënien e shërbimit juridik falas, në zbatim të Ligjit Nr. 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti"?

4. Nëse po, cila është procedura që ndiqet prej intitucionit tuaj që në momentin e ardhjes së subjektit përfitues apo të kërkesës për këtë lloj shërbimi

5. Sa ankesa ka patur deri më tani?

6. A mbani regjistër të dhënash (të zakonshëm dhe statistikor sipas Kreut III të ligjit) mbi kërkesat që vijnë për përfitimin e shërbimit juridik falas nga qytetarët?

- a. Po, por vetëm regjistër të zakonshëm
- b. Po, por vetëm regjistër statistikor
- c. Po, të dy llojet e regjistrave
- d. Jo

6. Më së shumti, prej intitucionit tuaj është dhënë ndihmë juridike parësore apo dytësore?

- a. Kryesisht parësore
- b. Kryesisht dytësore
- c. Të dyja
- d. Asnjëra

7. A janë organizuar fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj nga ana e institucionit tuaj?

- a. Po
- b. Jo

Shpjegim:

Si do ta vlerësonit bashkëpunimin me institucionet e tjera të parashikuara nga ligji?

Institucioni	Dobët	Mesatar	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Ministria e Drejtësisë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dhoma Kombëtare e Avokatisë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Gjykatat kompetente	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Institucione te tjera shtetërore Specifiko: _____	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------